



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 191 Akti

Nr. 264 Vendimi  
Tiranë, më 17.06.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Firdes Shuli** Kryesuese  
**Pamela Qirko** Relatore  
**Etleda Çiftja** Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 12.06.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elona Toro**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Firdes Shuli dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 3.10.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Alma Faskaj dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, Komisioni vendosi rishpërndarjen me short të çështjeve për vitet 2018 dhe 2019 të komisioneres Alma Faskaj, për shkak se ka njoftuar se do të mungojë për një kohë të pacaktuar për arsye shëndetësore.
7. Në vijim, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.3.2020, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e çështjeve të komisioneres znj. Alma Faskaj, me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, të caktuara me procedurat e shortit të muajve shtator, nëntor 2018 dhe janar, mars dhe nëntor 2019”, nga procedurat e shortit rezultoi se për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro - znj. Alma Faskaj zëvendësohet nga komisionere Etleda Çiftja, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.
8. Prosesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
9. Prosesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

10. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

11. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

12. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

13. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

15. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

16. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 12.7.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 4.4.2018.

<sup>2</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019.

tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

17. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në datën 12.7.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 15.7.2019, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datën 22.7.2019.

18. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

19. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail*, në datën 10.06.2020.

20. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 12.06.2020, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

21. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

22. Znj. Elona Toro ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

22.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

23. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të

proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

23.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23.4 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

23.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017<sup>4</sup> dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

25. Pas marrjes së raportit të hollësishtëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

25.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në

---

<sup>4</sup>“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

25.2 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

**26. Pasuria e llojit apartament<sup>5</sup>**, me sip. 112.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, i ndodhur në “\*\*\*\*” Tiranë, me vlerë 135,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

Si burim krijimi për këtë pasuri subjekti ka deklaruar: (i) shumën prej 5,800,000 lekësh të përfituar nga kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 4.9.2009, për shitjen e apartamentit të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë; (ii) shumën 45,000 euro, të marrë hua nga shtetasi A.Ll., sipas kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 23.7.2008; (iii) shumën prej 5,000,000 lekësh, të përfituar nga kredia bankare sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 10.2.2011; si dhe (iv) shumën prej 1,980,000 lekësh, të përfituar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Tiranë me nr. \*\*\*, datë 20.3.2006.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

Në deklaratimet e bëra, ndër vite, lidhur me këtë pasuri në ILDKPKI, referuar deklaratës periodike vjetore (në vijim DPV) të vitit 2009 konstatohet se në rubrikën “ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” subjekti ka deklaruar se: (i) ka porositur te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 130 m<sup>2</sup>, me vlerë 135,000 euro, të ndodhur në “\*\*\*\*” Tiranë; dhe (ii) në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar detyrim pa shlyer (sipas kësteve të parashikuara në kontratë) ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Analiza ligjore/financiare e burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie**

#### *i. Shuma 5,800,000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit*

Në deklarinimin e kësaj pasurie në vite, referuar deklaratës fillestare të deklarinimit të pasurisë, konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament në bashkëpronësi me babanë, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, përfituar nga ligji nr. 7652, datë 31.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Ndërsa, referuar DPV-së së vitit 2009 subjekti ka deklaruar se me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 4.9.2009, së bashku me babanë ka shitur apartamentin me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, për vlerën 5,800,000 lekë.

Origjina e kësaj pasurie: referuar dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se në datën 8.12.1993, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj kanë blerë<sup>6</sup> pasurinë e llojit apartament nga Ndërmarrje Komunale Banesa Nr.1, për vlerën 25,660 lekë. Në datën 3.2.2003, nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore për të ndjerën, nënën e subjektit, nga ku si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe babai zotëronin secili ½ pjesë të kësaj pasurie.

<sup>5</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*dhe aneks \*\*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së): (1) certifikatë pronësie nr. \*\*\*, lëshuar datë 1.10.2012; (2) kopje e kartelës së pasurisë; (3) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 4.9.2009 dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj; (4) kontratë huaje nr. \*\*\* kol., datë 23.7.2008 (2009); (5) vendim gjykatë nr. \*\*\* Akti, nr. \*\*\* vendimi, datë 20.3.2006; dhe (6) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2006.

<sup>6</sup> Konfirmuar kontrata e shitblerjes me vërtetimin noterial nr. \*\*\*, datë 9.12.1993.

Konstatohet se nëpërmjet kontratës<sup>7</sup> së shitjes së pasurisë së paluajtshme të datës 4.9.2009, subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj e kanë shitur këtë pasuri për vlerën 5,800,000 lekë. Referuar kësaj kontrate, palët kanë deklaruar se kjo shumë është shlyer tërësisht nga pala blerëse në favor të palës shitëse jashtë zyrës noteriale.

Gjithashtu, rezulton se me realizimin e kësaj shitjeje është paguar tatimi në shumën prej 381,056 lekësh. Si rrjedhim, të ardhurat *neto* të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i saj nga shitja e kësaj pasurie janë në vlerën prej 5,418,944 lekësh.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar saktë mënyrën e përfitimit të vlerës prej ½ nga shitja e kësaj pasurie në bashkëpronësi me babanë, ligjërisht pjesë takuese e babait të saj.

Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë konstatim, në prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se [...] *në deklarin periodik vjetor të vitit 2009 ka shënuar se shuma prej 5,800,000 lekësh është përfitur nga shitja e apartamentit, në bashkëpronësi me babanë dhe meqenëse gjysmën ligjore të kësaj shume babai ia dha pa ndonjë kontratë dhurimi apo aktmarrëveshje nuk e ka shënuar si dhurim [...].*

Në vijim subjekti ka shpjeguar se [...] *shuma prej 5,800,000 lekësh është përdorur e gjitha prej saj (minus tatimin përkatës) dhe është deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” si burim që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 112.7 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, por përsëri pa u shënuar që ½ është dhuruar prej babait të saj, në mungesë të ndonjë akti noterial për dhurimin e pjesës takuese, por nisur nga marrëdhëniet specifike, kjo gjë konsiderohet e prezumuar, prandaj edhe shuma e plotë e përfitur nga shitja me miratimin e babait u kalua në llogarinë e tyre (të subjektit/bashkëshortit të saj) [...].*

Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, si dhe në prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit lidhur me marrjen e plotë të shumës nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se përpos faktit të marrëdhënies së posaçme prind – fëmijë (për më tepër duke qenë se është fëmijë i vetëm), subjekti/familja e saj e ka ndihmuar babanë në blerjen e pasurisë së llojit “apartament banimi”, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, porositur prej tij në vitin 2004.

Gjatë hetimit administrativ është provuar se përgjatë viteve 2005 – 2009, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar nëpërmjet bankës<sup>8</sup>, në favor të shtetasit A.LL., në total shumën prej 2,020,000 lekësh me përshkrimin “likuidim/shlyerje borxhi” dhe se në referim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kjo shumë përfaqëson kthim huaje të marrë nga babai i saj për prenotimin e apartamentit në vitin 2004.

Për më tepër, referuar DPV-së së vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka pakësuar pasurinë në vlerën prej 600,000 lekësh, duke shpjeguar se bonot e privatizimit në shumën prej 600,000 lekësh, në emër të saj dhe të bashkëshortit i kanë tërhequr dhe ia kanë dhënë babait të saj, për blerjen e apartamentit në Rr. “\*\*\*\*”, pranë kishës katolike, apartament ky i porositur në vitin 2004 nga babai i subjektit të rivlerësimit.

Por, nga verifikimi i shkresës së ardhur nga Banka e Shqipërisë<sup>9</sup> konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur të hapur llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit

<sup>7</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 4.9.2009.

<sup>8</sup> Referojuni dokumentacionit bankar të BKT-së.

<sup>9</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019.

shqiptar dhe se referuar të dhënave të dërguara në datën 14.10.2004, është *maturuar* dhe tërhequr shuma prej 400,000 lekësh, si dhe në datën 28.10.2004 është *maturuar* dhe tërhequr shuma prej 300,000 lekësh.

E pyetur nga Komisioni lidhur me destinacionin e këtyre shumave pas tërheqjes, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>10</sup> [...] *destinacioni i shumës prej 700,000 lekësh, pas kthimit të investimit në bono thesari (nga llogaria dyemërore me bashkëshortin) iu dha babait dhe u përdor prej tij si pagesë për blerjen e apartamentit të tij, në Rr. “\*\*\*”, pranë kishës katolike [...].*

Pra, duket se përpara se të merrte shumën e plotë nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me babanë, në vitin 2009 (shuma totale *neto* 5,418,944 lekë), subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti e kanë ndihmuar financiarisht z. K.S., (babanë e subjektit) nëpërmjet dhënies së shumës prej 700,000 lekësh, pas kthimit të bonove të thesarit në emër të tyre dhe shlyerjes së një pjese të huas së marrë prej tij, sipas informacionit bankar dhe deklarimeve të subjektit në shumën prej 2,020,000 lekësh.

Në konsideratë të faktit se ½ e vlerës *neto*, të përfituar nga shitja e apartamentit në vitin 2009 (pas pagesës së tatimit) është 2,709,472 lekë (5,418,944 lekë/2) dhe vlera e ndihmës financiare të dhënë në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj në favor të z. K.S., (deri në vitin 2009) për prenotimin e apartamentit në vitin 2005 është në shumën 2,720,000 lekë, duket se me përfitimin e shumës së plotë nga shitja e apartamentit në vitin 2009 subjekti është “*kompensuar/i janë kthyer shumat*” për vlerat e dhëna ndër vite për babanë e saj – kjo në këndvështrim edhe të marrëdhënies së posaçme mes tyre dhe faktit se subjekti i rivlerësimit është i vetmi trashëgimtar ligjor i radhës së parë.

Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja<sup>11</sup> konstatohet se në datën 8.9.2009 (4 ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitjes së pasurisë në bashkëpronësi të subjektit dhe babait) në llogarinë<sup>12</sup> e bashkëshortit të subjektit është depozituar shuma prej 5,800,000 lekësh. Në vijim, konstatohet se po në datën 8.9.2009 nga kjo llogari është tërhequr shuma prej 500,000 lekësh. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me shitjen e kësaj pasurie duket se në datën 8.9.2009 është kryer pagesa e tatimit mbi shitjen e kësaj pasurie në shumën prej 381,056 lekësh. Shuma e mbetur, e depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit është përdorur plotësisht për pagesën e këstit të dytë për blerjen e apartamentit të ndodhur në “\*\*\*”, Tiranë, pagesë e cila do të trajtohet në mënyrë të detajuar në vijim të këtij vendimi.

Nga analiza në tërësi e provave të administruara lidhur me përfitimin e kësaj shume konstatohet se:

- a) Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë së llojit apartament, të ndodhur në “\*\*\*” Tiranë, vlerën e plotë të përfituar nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me babanë në vitin 2009.
- b) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 (të depozituar në ILDKPKI) në rubrikën “ndryshimet e interesave private – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” subjekti ka shënuar si ndryshim – shtesë pasurie vlerën e plotë prej 5,800,000 lekësh, duke deklaruar se me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, së bashku me babanë kanë shitur apartamentin e ndodhur në Rr. “\*\*\*” Tiranë.
- c) Referuar deklarimeve periodike vjetore të bëra në ILDKPKI (DPV-ja e vitit 2005), informacionit të administruar nga bankat, si dhe shpjegimeve të dhëna në kuadër të hetimit administrativ të bërë nga Komisioni, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, në vazhdimësi (deri në vitin

<sup>10</sup> Pyetësori nr. 4, pyetja nr. 1/nëpyetja iii – përgjigjja e dërguar nga subjekti.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 6.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 6.2.2019.

<sup>12</sup> Llogaria nr. \*\*\*, në lekë.



2009), kanë dhënë/kaluar vlera monetare për/në favor të z. K.S., si ndihmë financiare për kryerjen e pagesave për prenotimin e pasurisë në vitin 2004, si dhe shlyerjen e huas së marrë me qëllim blerjen e kësaj pasurie, vlera të cilat në total shkojnë përafërsisht sa ½ e vlerës së përfituar nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi në vitin 2009.

- d) Nga verifikimi i llogarive bankare në BKT të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit konstatohet se 4 ditë pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë, në bashkëpronësi të subjektit dhe babait të saj, është kredituar vlera prej 5,800,000 lekësh dhe se pas tërheqjes së një shume prej 500,000 lekësh (shumë e cila duket se ka shërbyer për pagesën e tatimit), vlera e mbetur në këtë llogari dokumentohet plotësisht se ka shërbyer për pagesën e kështit të dytë për blerjen e apartamentit të ndodhur në “\*\*\*”.

Në këtë kontekst, verifikimi i këtij fakti, përfitimit nga subjekti të shumës së plotë nga shitja e pasurisë në bashkëpronësi me babanë, merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive.

Nga hetimi administrativ i kryer ka rezultuar se subjekti, në vazhdimësi, ka deklaruar se vlera e shitjes së pasurisë në bashkëpronësi me babanë është përfituar plotësisht prej saj dhe se ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në “\*\*\*\*” Tiranë. Në këtë këndvështrim, Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklaram janë pa pasoja dhe, si të tilla, nuk janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

Për sa më sipër, në vlerësimin tërësor dhe në harmoni të provave shkresore të administruara në dosje, transaksioneve të kryera, deklarameve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, në ILDKPKI dhe shpjegimeve të dhëna nëpërmjet pyetësorëve/prapësimeve të dërguara në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues krijoi bindjen se të ardhurat (minus tatimin e paguar) nga shitja e apartamentit në vitin 2009 në bashkëpronësi me babanë janë përfituar plotësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt hetimi.

#### *ii. Shuma 45,000 euro, marrë hua nga shtetasi A.Ll.*

Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë huaje me nr. \*\*\*, datë 23.7.2008, me huadhënës z. A. Ll., në shumën 45,000 euro. Subjekti ka deklaruar se qëllimi i marrjes së kësaj huaje është blerja e apartamentit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar identitetin dhe adresën e plotë të huadhënësit. Detyrimi i mbetur në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” është në vlerën 15,000 euro.

Deklarimi i huas në vite: referuar DPV-së së vitit 2009 konstatohet se në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar kontratë huaje nr. \*\*\* kol., datë 23.7.2009, sipas së cilës bashkëshorti i ka marrë hua z. A.Ll., shumën prej 45,000 euro dhe detyrimin ndaj këtij të fundit në shumën prej 45,000 euro. Gjithashtu, në vijim, në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar shlyerje të kësaj huaje, si vijon: (i) në DPV-në e vitit 2010, shumën prej 5,000 euro; (ii) në DPV-në e vitit 2012, shumën prej 5,000 euro; (iii) në DPV-në e vitit 2013, shumën prej 5,000 euro; (iv) në DPV-në e vitit 2014, shumën prej 5,000 euro; (v) në DPV-në e vitit 2015, shumën prej 5,000 euro; dhe (vi) në DPV-në e vitit 2016, shumën prej 5,000 euro.

• *Mënyra/periudha e kalimit të shumës së dhënë hua dhe e shumave të kthyera në favor të huadhënësit, shtetasit A. Ll.,*

Lidhur me mënyrën e kalimit të shumës prej 45,000 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma prej 10,000 euro (kësti i parë i kontratës) është dhënë *cash* në korrik të vitit 2009. Ndërsa shuma prej 35,000 euro (kësti i dytë i kontratës) është lëvruar në datën 24.3.2010 në dy pjesë, 4,500,000 lekë (të cilat në atë kohë konvertoheshin në 32,500 euro) kaluan në transfertë bankare në llogarinë në BKT, të bashkëshortit, z. A.T., dhe 2,500 euro u dhanë *cash* dhe kjo pagesë është pjesë e kështit të tretë të kontratës së sipërmarrjes.

Referuar kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 23.7.2008, konstatohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.T., ka marrë nga z. A.Ll., hua në shumën prej 45,000 euro, me qëllim financimin pjesërisht të blerjes së një apartamenti me sip. 126 m<sup>2</sup>, përballë diskos “\*\*\*\*”, me interes 3 (tre) % në vit.

Në nenin 2 të kësaj kontrate, me titull “kushtet e huas” përcaktohet se huadhënësi do të lëvrojë në favor të huamarrësit shumën 45,000 euro me këste, si vijon: (i) 10,000 euro, në datën 28.7.2009; dhe (ii) 35,000 euro, në datën 31.10.2009.

Megjithëse në kontratën e huas parashikohej se shuma prej 45,000 euro do të jepej plotësisht gjatë vitit 2009, subjekti deklaroi se një pjesë të huas e ka marrë në vitin 2010, konfirmuar ky fakt nëpërmjet dokumentacionit bankar. Në këtë kuptim, duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në vitin 2009, duke deklaruar si detyrim ndaj huadhënësit shumën e plotë prej 45,000 euro.

Në prapësimet e dërguara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se në deklaratën periodike vjetore ka vlerësuar faktin e shënimit të vlerës së plotë të shumës prej 45,000 euro, sipas parashikimit të bërë në kontratën e huas, por edhe për faktin se shuma e plotë është përfituar në periudhën e plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës periodike të vitit 2009 (përkatësisht në mars të vitit 2010).

Gjithashtu, me prapësimet e sjella, por edhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka sqaruar se meqenëse në datën 4.9.2009 u realizua shitja e pasurisë në bashkëpronësi me babanë dhe se nëpërmjet këtij transaksioni siguroi të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e pagesës së kështit të dytë<sup>13</sup> në favor të shoqërisë ndërtuese, kjo bëri që të mos lëvrohej kësti i dytë sipas parashikimeve të bëra në kontratën e huas, por u spostua në kohë për të rakorduar me pagesën e kështit të tretë sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e porosisë<sup>14</sup>.

Në vlerësim të rrethanave të mësipërme, Komisioni çmon se duken bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me këtë pasaktësi në deklaram, kjo nisur edhe nga fakti se subjekti, në kuadër të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka saktësuar periudhën e përfitimit të vlerave monetare nga kontrata e huas, si dhe në deklaratat periodike vjetore vijuese të depozituara në ILDKPKI ka deklaruar, në vazhdimësi, shumat e shlyera dhe detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se kjo pasaktësi në deklaram (në DPV-në e vitit 2009) është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

<sup>13</sup> Parashikuar në kontratën e porosisë që të paguhej në datën 30.10.2009, por paguar në datën 9.11.2009, konfirmuar me transaksion bankar.

<sup>14</sup> Kësti i dytë i huas i lëvruar në datën 24.3.2010. Pagesa e kështit të tretë parashikuar në kontratë për t’u paguar në datën 31.3.2010, por në fakt është ekzekutuar në datën 25.3.2010 – konfirmuar me transaksion bankar.

Nga verifikimi i llogarisë bankare në BKT të bashkëshortit të subjektit (llogaria në lekë me nr. \*\*\*) konfirmohet se në datën 24.3.2010 është transferuar shuma prej 4,500,000 lekësh, nga z. A.Ll., me përshkrimin “dhënie huaje sipas kontratës”.

Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni<sup>15</sup>, subjekti ka sqaruar se *në faqen e parë të kontratës së huas është shënuar viti 2008, por viti i saktë është viti 2009*. Gjithashtu, ka bashkëlidhur si provë fletën e regjistrit noterial ku është regjistruar kjo kontratë.

Notere A.A., (M.)<sup>16</sup>, e cila ka redaktuar kontratën e huas, na konfirmon se ka bërë një lapsus në vitin e redaktimit të kësaj kontrate, duke na vënë në dispozicion fotokopjet e faqeve të regjistrit të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale të vitit 2009 dhe fotokopjen e faqes së Indeksit të vitit 2009, në të cilin është regjistruar ky akt noterial në bazë të ligjit.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se pagesat e kryera gjatë viteve përfaqësojnë pagesa të detyrimit kryesor të huas dhe se interesi do të paguhet pasi të jetë bërë pagesa e plotë e principalit.

E pyetur nga Komisioni lidhur me pagesat e kryera për shlyerjen e kësaj huaje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ndër vite janë kryer shlyerjet në favor të z. A.Ll., të pasqyruara në tabelën, si më poshtë:

Periudha	Vlera në euro	Mënyra e pagesës
Fundviti 2010	5000	Cash
Maj 2011	2000	Transfertë BKT nga kredia
Fundviti 2012	3000	Cash nga kursimet
Korrik 2013	5000	BKT nga kursimet
Gusht 2014	5000	BKT nga kursimet
Nëntor 2015	5000	BKT nga kursimet
Nëntor 2016	5000	BKT nga kursimet
Korrik 2018	5000	BKT nga kursimet
Maj 2019	5000	BKT nga kursimet

Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit konfirmohen shlyerjet e këtyre shumave të kryera nëpërmjet transaksioneve bankare të vetëdeklaruara nga subjekti, të pasqyruara, si më sipër.

Pra, duket se deri në datën 31.12.2016 shuma prej 30,000 euro është shlyer në favor të z. A. Ll., e cila përputhet me shumën e shlyer të deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

Por ndërkohë, në referim të deklarimeve periodike vjetore të depozituara nga subjekti, ndër vite, në ILDKPKI konstatohet se për vitin 2011 nuk ka deklaruar shumë të shlyer ndaj huadhënësit z. A. Ll., ndërsa për vitin 2012 ka deklaruar shumën e shlyer në vlerën prej 5,000 euro.

Pasi iu kërkuan shpjegime për mospërputhjet në deklaratimet e bëra lidhur me shumën e shlyera në favor të huadhënësit, z. A.Ll., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se *[...] në vitin 2011 nga BKT-ja ishte lëvruar në favorin e saj kredia në shumën prej 5,000,000 lekësh (deklaruar në formularin përkatës në DPV-në e vitit 2011). Nga kjo shumë, pasi u bë likuidimi i kështit të fundit në favor të shoqërisë ndërtuese, mbetën 2,000 euro, të cilat, direkt nga llogaria e saj kaluan në llogarinë e*

<sup>15</sup> Referojuni përgjigjeve të dërguara me e-mail-in e datës 20.9.2019 (përgjigje nr. 5).

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 9.10.2019, e protokolluar në Komision.

huadhënësit, z. A.Ll. Por, ky fakt u harrua në momentin e plotësimit të formularit përkatës në DPV-në e vitit 2011. Këtë rrethanë e ka korigjuar në formularin përkatës të DPV-së së vitit 2012, ku krahas shumë prej 3,000 euro, që kishin likuiduar në favor të huadhënësit në vitin 2012 ka përfshirë edhe shumë prej 2,000 euro, të likuiduar në vitin 2011, por të padeklaruar, duke shënuar shumë e plotë të likuiduar në vlerën prej 5,000 euro [...].

Nga verifikimi i llogarisë bankare në BKT<sup>17</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit, konfirmohet se në datën 10.5.2011 është transferuar në favor të shtetasit A.Ll., shuma prej 2,000 euro, me përshkrimin “likuidim borxhi sipas deklaratës noteriale për blerje apartamenti”.

Në kushtet kur subjekti ka vetëdeklaruar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni shumë e shlyer prej 2,000 euro në vitin 2011, të konfirmuar nëpërmjet transaksionit bankar, trupi gjykues çmon se duken bindëse shpjegimet për harresën në deklaram në vitin 2011 dhe për përfshirjen e kësaj shume në deklaratën e vitit 2012 dhe se kjo harresë/pasaktësi në deklaram është pa pasoja, me peshë specifike shumë të vogël dhe, si e tillë, nuk ndikon në procesin e rivlerësimit.

Në vështrim të përgjithshëm, Komisioni evidenton faktin se marrëdhënia juridike e huadhënies është e plotë nga pikëpamja formale, konkretizuar me kontratë noteriale huaje - veprim juridik i dyanshëm, ku pasqyrohen qartësisht të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe vërehet se ekzekutimi dhe vazhdimësia e kësaj marrëdhënieje, si dhe shlyerjet e huas janë kryer kryesisht nëpërmjet sistemit bankar.

- *Marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me huadhënësin, z. A.Ll.*

E pyetur nga Komisioni lidhur me marrëdhënien që ka me huadhënësin, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se<sup>18</sup> shtetasi A.Ll., është mik i ngushtë i bashkëshortit dhe se ka marrëdhënie të hershme miqësie të ngushtë familjare mes tyre.

Gjithashtu, nga hetimi i kryer nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar ndonjë çështje civile/penale, ku si palë ndërgjyqëse, kallëzues/i kallëzuar/i dëmtuar/person nën hetim etj., të jetë huadhënësi, shtetasi A.Ll.

- *Analiza e burimit të shumë/vlerës së dhënë hua nga shtetasi A. Ll.*

Në referim të pikës 14, të nenit 3, si dhe të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. A.Ll., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. A.Ll., të cilat kanë krijuar shumë e dhënë hua bashkëshortit të saj.

Lidhur me burimin e të ardhurave të shtetasit A.Ll., subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>19</sup> rrjedhin nga: (i) aktiviteti tregtar që në vitin 1993, me NIPT \*\*\*; (ii) shitja e apartamentit në Shkodër në vitet 1995 – 1996; (iii) aksionet te shoqëria “\*\*\*” sh.a; (iv) shuma e fituar nga shitja e aksioneve në shoqërinë “\*\*\*” sh.a.; (v) shuma e shitjeve të pasurive të paluajtshme, të ndodhura në Tiranë (ku një nga bashkëpronarët ishte babai i tij); (vi) të ardhurat e investimeve në bono thesari; (vii) ekzekutimi i vendimit gjyqësor të vitit 2004, dalë në favor të babait të tij; si dhe (viii) qiradhëniet e pasurive të paluajtshme të kthyer nga KKKPishP-ja dhe nga pronat që i janë dhuruar.

---

<sup>17</sup>Llogaria nr. \*\*\*, në euro.

<sup>18</sup>Pyetësori nr. 2, dërguar me e-mail, datë 10.9.2019/përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail, datë 20.9.2019 (referojuni pyetjes nr. 5, përgjigjes nr. 5, nënpyetja i).

<sup>19</sup>Pyetësori nr. 2, dërguar me e-mail, datë 10.9.2019/përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail, datë 20.9.2019 (referojuni pyetjes nr. 5/përgjigjes nr. 5, nënpyetja vi).

Në sqarimet e saj, subjekti është bazuar në deklaratën noteriale<sup>20</sup> të shtetasit A.Ll., të datës 19.9.2019, i cili ka shpjeguar burimet e krijimit të të ardhurave që kanë plotësuar shumën e dhënë hua.

Gjithashtu, për të provuar deklaratimet e saj për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi A.Ll., subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka depozituar në Komision fotokopje të dokumenteve, si vijon: (1) ekstrakt të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit tregtar “\*\*\*\*” Person Fizik; (2) ekstrakt të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*\*” sh.a.; (3) ekstrakt të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*\*” sh.a.; (4) nxjerrje llogarie (*statement*) të bonove të thesarit nga Banka e Shqipërisë; (5) nxjerrje llogarie (*statement*) nga BKT-ja për llogaritë në valutën euro dhe USD; (6) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019, nga drejtoria e pagesave të dëmshpërblimeve; (7) vërtetim pronësie për pasuri të pretenduara të dhëna me qira ndër vite; (8) vendime të KKKPishP-së për prona të kthyer në favor të trashëgimlënësit të z. A. Ll., dhe të nënës së tij; (9) vërtetim pronësie të magazinës me sip. 882 m<sup>2</sup>, ku babai i z. A.Ll., zotëron ½ pjesë; (10) kontrata dhurimi pasurie të paluajtshme në favor të z. A.Ll.; (11) kontrata shitjesh pasurie të paluajtshme, ku bashkëpronar është babai i z. A.Ll.; si dhe (12) certifikatë e përbërjes familjare të z. A.Ll., deri në datën 6.8.2011.

Me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në vlerësim të dokumentacionit të mësipërm, Komisioni i kërkoi<sup>21</sup> sërish subjektin të rivlerësimit të pasqyrojë rast pas rasti të ardhurat e përfituara nga babai i z. A.Ll., se cila ka qenë shuma e përfituar prej tij nga këto të ardhura (në kohë dhe në vlerë) dhe nëse z. A.Ll., ka pasur të ardhura të tjera të vërtetuara (përfshirë paga, shpërblime, fitime nga aktivitete të regjistruara, qiradhënie, dividendë, interesa, hua, kredi etj.) për dhënien e shumave prej 10,000 euro dhe 35,000 euro në vitet 2009 dhe 2010. Subjektin iu kërkua të deklarojë në mënyrë kronologjike burimin e krijimit të të ardhurave të z. A.Ll., të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, të dërguar në Komision<sup>22</sup>, bazuar në dokumentacionin e administruar prej huadhënësit, z. A.Ll., si dhe bazuar në thëniet e tij, subjekti ka bërë një analizë të të ardhurave që ka përfituar ky shtetas dhe babai i tij për periudhën 1994 – 2009, të pasqyruara, si më poshtë:

Të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga z. A.Ll., ndër vite:

Periudha/ viti	Të ardhura në lekë	Përshkrim/burimi
1994	175,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
1995	225,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2020
1996	491,667	Nga aktiviteti tregtar fitim 125,000 lekë dhe pjesa takuese nga shitja e banesës në Shkodër (1,100,000 lekë/3)
1997	304,200	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
1998	200,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
1999	1,000,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2000	1,000,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2001	1,000,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019

<sup>20</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2019.

<sup>21</sup> Pyetësori nr. 4, dërguar me e-mail-in e datës 16.10.2019.

<sup>22</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar me e-mail-in e datës 25.10.2019.

2002	1,000,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2003	125,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2004	125,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2005	250,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2006	333,333	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
2007	500,000	Deklaruar fitim 50 % të xhiros P. Fizik referuar shkresës së DRT-së Tiranë, datë 23.10.2019
<b>Totali</b>	<b>6,729,200</b>	

Lidhur me të ardhurat e pasqyruara si të përfituara nga z. I.Ll., (babai i huadhënësit A. Ll.) nga shitja e disa pasurive të paluajtshme ku shfaqet si bashkëpronar, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar pjesën takuese të z. I.Ll., në këto pasuri të shitura. Subjekti i rivlerësimit depozitoi<sup>23</sup> dokumentacionin shtesë lidhur me shitjen e këtyre pasurive: (1) kopje të fletës së regjistrit hipotekor nr. \*\*\*, datë 11.10.1996; dhe (2) fotokopje dokumentacioni arkivor nr. reference \*\*\*, z. k. \*\*\*, të cilat kanë të bëjnë me pasuri të shitura nga babai i huadhënësit, z. I.Ll., në cilësinë e bashkëpronarit.

Në analizë të dokumentacionit të mësipërm, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të ardhurat e përfituara të z. I.Ll., nga shitja e pasurive të paluajtshme, shitja e aksioneve që zotëronte në një shoqëri tregtare, si dhe nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik për periudhën objekt hetimi pasqyrohen më poshtë.

Të ardhurat e përfituara ndër vite, nga z. I.Ll.,:

Datë	Vlera në lekë nga shitje pasurie	Pjesa takuese në lekë	Përshkrimi/burimi
12.8.1996	1,100,000	366,667	Pjesa takuese e deklaruar 33,33 %
12.2.1998	706,800	117,800	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
26.3.1999	930,000	155,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
26.3.1999	456,000	76,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
7.5.1999	625,350	104,225	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
7.5.1999	1,126,400	187,733	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
7.5.1999	960,000	160,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
28.1.2000	720,000	120,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
3.2.2000	456,000	76,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
3.2.2000	1,350,000	225,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
29.12.2000	1,800,000	300,000	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
8.3.2001	2,000,000	333,333	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
1.10.2001	1,700,000	283,333	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
10.10.2006	2,000,000	333,333	Pjesa takuese 1/3 e ½ pjesë
20.6.2008	225,000	225,000	Nga shitja e aksioneve (2,035%) në shoqërinë “***”
		315,122	Nga dëmshpërblimet si i përndjekur për periudhën 1994 – 2005
<b>Totali</b>		<b>3,378,547</b>	

<sup>23</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 5, dërguar me e-mail-in e datës 20.11.2019.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në analizën e të ardhurave të pasqyruara në tabelat e mësipërme nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat nga pensioni i z. I.Ll., dhe znj. D.Ll., (prindërit e z. A.Ll.); (ii) të ardhurat nga pagesat e dëmshpërblimit, ku kësti i parë i është paguar z. I.Ll., në të gjallë dhe këstet e tjera u janë lëvruar trashëgimtarëve të radhës së parë të tij; (iii) të ardhurat nga qiratë e objekteve në pronësi të tyre; (iv) interesat bankare dhe interesat e bonove të thesarit; si dhe (v) të ardhurat nga shitja që z. A.Ll., i ka bërë aksioneve të tij në shoqërinë “\*\*\*\*”.

Për të provuar deklaratimet e saj për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi A.Ll., subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, ndër të tjera, ka depozituar në Komision dokumentacionin, si vijon: (1) shkresë nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2019, bashkëlidhur saj kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 12.8.1996; (2) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 12.2.1998; (3) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 26.3.1999; (4) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 26.3.1999; (5) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.5.1999; (6) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.5.1999; (7) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.5.1999; (8) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 28.1.2000; (9) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 3.2.2000; (10) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 3.2.2000; (11) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 29.12.2000; (12) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 8.3.2001; (13) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 1.10.2001; (14) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 10.10.2006; (15) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019, lëshuar nga ISSh-ja Drejtoria Rajonale Tiranë; (16) ekstrakt historik i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*\*” sh.a.; (17) vërtetim i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2019; (18) vërtetim i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2019; (19) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019, lëshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve; (20) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.10.2019; si dhe (21) ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “\*\*\*\*” sh.a.

Konstatohet se në deklaratën noteriale<sup>24</sup> të datës 23.10.2019, nëna dhe motra e z. A.Ll., (huadhënësit), ndër të tjera, kanë deklaruar se *pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të të ndjerit I.Ll., janë administruar me pëlqimin e tij dhe në dijeninë e tyre nga djali/vëllai A. Ll., dhe se ka pasur tagra të plota për të administruar të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme, të ardhurat e qirave apo çdo të ardhure tjetër, të krijuar nga trashëgimlënësi i tyre I.Ll.*

Gjithsesi, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi sërish subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime shtesë lidhur me pretendimin se huadhënësi, z. A.Ll., ka administruar me tagra të plota pasuritë e babait të tij.

Në prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *[...] për administrimin e pasurive të luajtshme të z. I.Ll., nga i biri i tij (në të gjallë të tij), z. A.Ll., i ka pohuar se mes tyre nuk ka pasur ndonjë akt të posaçëm për të rregulluar këtë marrëdhënie. Kjo në radhë të parë për lidhjen mes tyre si babë e bir, por edhe si rrjedhojë e traditës shqiptare, pasi, si djalë i vetëm, që jetonte me prindërit, marrëdhënia e besimit mes tyre nuk vihej në dyshim. Ky fakt konstatohet lehtësisht edhe në rastin e llogarisë dyemërore të bonove të thesarit në Bankën e Shqipërisë, ku I., dhe A., kishin të njëjtën llogari, pa përcaktuar pjesët e secilit. Një mënyrë e tillë menaxhimi të pasurive përbënte lehtësim për familjen e tyre, kjo edhe për shkak të moshës që kishte z. I. Ll., i lindur në vitin 1926 [...]*”.

---

<sup>24</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 23.10.2019, depozituar si dokument me përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti<sup>25</sup>, Komisioni vëren se që prej vitit 2002 huadhënësi, z. A.Ll., dhe babai i tij, z. I.Ll., kanë pasur llogari dyemërore në investime për bono thesari në Bankën e Shqipërisë, të cilat janë në vlera të konsiderueshme.

Nga analizimi në tërësi i të dhënave dhe provave të evidentuara si më sipër, i (i) llogarisë dyemërore në emër të huadhënësit dhe babait të tij në Bankën e Shqipërisë; (ii) deklaratës noteriale të bërë nga huadhënësi; (iii) deklaratës noteriale të bërë nga nëna dhe e motra e huadhënësit, si edhe në vlerësim të sqarimeve të dhëna nga subjekti lidhur me marrëdhënien e huadhënësit me babanë e tij dhe marrëdhënien e ngushtë miqësore të hershme mes dy familjeve, familjes së bashkëshortit dhe të huadhënësit<sup>26</sup>, Komisioni çmon se duken bindëse shpjegimet e dhëna lidhur me administrimin e pasurisë së familjes Ll., nga djali i tyre, huadhënësi z. A.Ll., dhe se nuk ka dyshime për dhënien e pëlqimit nga familjarët e tij për kalimin e shumës prej 45,000 euro, si hua në favor të z. A.T.

Komisioni vëren se lidhur me deklarin e burimit të krijimit të shumës prej 45,000 euro të marrë hua, subjekti i është referuar deklarimeve të huadhënësit, të cilat mbështeten nga familjarët e tij.

Deklarimet e dhëna nga huadhënësi dhe familjarët e tij, duke u konsideruar si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrin vlerë provuese të rëndësishme, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat e informacionet e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer.

Në këtë këndvështrim, si dhe në vlerësim të faktit se huadhënësi, z. A.Ll., ka qenë në të njëjtin trung familjar me babanë e tij (deri në vitin 2011, kur ka ndërruar jetë)<sup>27</sup>, Komisioni arrin në përfundimin se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme të z. I.Ll., të evidentuara me kontrata noteriale shitjeje, përfshirë edhe të ardhura të tjera të evidentuara me dokumentacion justifikues ligjor, do të pasqyrohen në analizën financiare të huadhënësit si të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 45,000 euro, të dhënë hua në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni kreu hetim pasuror për shtetasin A.Ll., për të evidentuar mundësinë e tij financiare për të dhënë huan në shumën prej 45,000 euro, në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se shtetasi A.Ll., nuk ka kryer investime në pasuri të paluajtshme, por se pasuritë e regjistruara në emrin e tij kanë si burim krijimi trashëgiminë ligjore<sup>28</sup>. Gjithashtu, referuar përgjigjes së ardhur nga DPSHTR-ja<sup>29</sup> duket se z. A.Ll., nuk ka kryer investime për blerje mjetesh motorike përpara dhënies së huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**DRT-ja Tiranë**<sup>30</sup> konfirmon se z. A.Ll., është regjistruar si Person Fizik me vendim gjykate nr. \*\*\*, datë 5.11.1993, me aktivitet “tregti me pakicë artikuj të ndryshëm”. Referuar kësaj shkrese, të ardhurat e realizuara ndër vite nga subjekti “\*\*\*” me NIPT \*\*\* janë, si më poshtë:

Periudha/viti	Xhiro realizuar/parashikuar në lekë	Tatim i paguar në lekë	Info
---------------	-------------------------------------	------------------------	------

<sup>25</sup> Dokumentacioni i dërguar në përgjigje të pyetjes nr. 5, të pyetësorit nr. 2.

<sup>26</sup> Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka paraqitur fotografi të hershme të familjes Toro së bashku me familjen Ll.

<sup>27</sup> Referuar certifikatës familjare të familjes Ll., lëshuar në datën 18.9.2019, për gjendjen familjare në datën 5.8.2011, ku konfirmohet se z. I.Ll., ka ndërruar jetë në datën 6.8.2011, depozituar nga subjekti si provë në përgjigje të pyetjes nr. 5, të pyetësorit nr. 2.

<sup>28</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2019, drejtuar ASHK-së, si dhe përgjigjet e ardhura të bëra pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer për personin tjetër të lidhur.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2019.



1994	350,000	25,000	Deklaratë për xhiron e realizuar dhe parashikuar
1995	450,000	40,000	Deklaratë për xhiron e realizuar dhe parashikuar
1996	250,000	40,000	Deklaratë për xhiron e realizuar dhe parashikuar
1997	608,400	30,420	Deklaratë për xhiron e realizuar dhe parashikuar
1998	400,000	20,000	Deklaratë për xhiron e realizuar dhe parashikuar
1999	2,000,000	22,500	Në xhiron deri në shumën 2,000,000 lekë
2000	2,000,000	22,500	Në xhiron deri në shumën 2,000,000 lekë
2001	2,000,000	22,500	Në xhiron deri në shumën 2,000,000 lekë
2002	2,000,000	13,500	Në xhiron deri në shumën 2,000,000 lekë
2003	250,000	18,000	Qarkullim i deklaruar
2004	250,000	20,000	Qarkullim i deklaruar
2005	500,000	0	Shitje brenda vendit deklaruar
2006	666,666	0	Shitje brenda vendit deklaruar
2007	0	0	Administruar nga Bashkia
<b>Totali</b>	<b>11,725,066</b>		

**Bashkia Tiranë**<sup>31</sup> informon se subjekti “\*\*\*” ka ushtruar veprimtarinë tregtare si ambulant nga data 5.11.1993, kohë kur është pajisur me kodin fiskal, deri më 31.12.2013, duke bashkëlidhur ndër të tjera, si dokumentacion: (i) fletën e njoftimit të vlerësimit tatimor për vitin 2007, e cila referuar legjislacionit në fuqi për kohën (ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”) i përgjigjej qarkullimit prej 0-2 milionë lekë; si dhe (ii) deklaratën parashikuese të qarkullimit vjetor me nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2008, sipas së cilës deklaruesi A.Ll., ka parashikuar qarkullimin prej 700,000 lekësh, për vitin 2008.

Nisur nga lloji i aktivitetit, periudhës në të cilën është kryer, qëndrimeve të mëparshme të mbajtura nga Komisioni, si dhe në mungesë të shpjegimeve bindëse të subjektit lidhur me llogaritjen e fitimit *neto* mbi qarkullimin e deklaruar<sup>32</sup>, trupi gjykues vlerësoi se shuma e fitimit *neto* nga aktiviteti tregtar i z. A.Ll., do të përlllogaritet 20 % e qarkullimit të deklaruar dhe për të cilin janë paguar detyrimet tatimore përkatëse, të konfirmuara nga organet tatimore qendrore dhe lokale.

#### **Të ardhura të tjera të evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ**

i. Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë, të ardhurave nga interesat e përfituara nga shtetasi A.Ll., për periudhën 2002 – 2009, kanë qenë në vlerën 978,035 lekë.

ii. Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja konstatohet se të ardhurat nga interesat e përfituara nga shtetasi A.Ll., për periudhën 2002 – 2009, kanë qenë në vlerën 297,253 lekë.

iii. Referuar të dhënave nga DPT-ja, shtetasi A.Ll., ka qenë aksioner në shoqërinë “\*\*\*” sh.a., me NIPT \*\*\*. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018, DTM-ja informon ILDKPKI-në se kjo shoqëri ka shpërndarë dividendë në vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2008. Sipas shkresës së sipërcituar të DTM-së, dividendi i shpërndarë deri në vitin 2008 është në vlerën 175,834,166 lekë. Të ardhurat e përfituara nga z. A.Ll., me burim dividendin e shpërndarë nga kjo shoqëri, përlllogariten në shumën prej 29,892

<sup>31</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 28.10.2019.

<sup>32</sup> Në vazhdimësi (përgjigje të pyetësorëve/prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit) subjekti ka pretenduar se bazuar në thëniet e z. A.Ll., fitimi *neto* i realizuar nga aktiviteti tregtar ka qenë sa 50 % e qarkullimit.

lekësh. Gjithashtu, nga QKB-ja<sup>33</sup> konfirmohet se shtetasi A.Ll., në datën 2.6.2008<sup>34</sup> ka shitur 45 aksione që zotëronte në këtë shoqëri, në vlerën 45,000 lekësh.

iv. Referuar të dhënave të dërguara nga DRT-ja Tiranë<sup>35</sup>, bazuar në përqindjen e aksioneve që shtetasi A.Ll., zotëronte në shoqërinë “\*\*\*” sh.a., duket se ka përfituar të ardhura nga shpërndarja e dividendit në shumën prej 9,352 lekësh.

v. Referuar të dhënave të dërguara nga ISSH-ja<sup>36</sup>, të ardhurave nga paga të përfituara nga z. A. Ll., për periudhën 2005 – 2009, janë në total në vlerën prej 806,724 lekësh.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ<sup>37</sup> u evidentua fakti se shtetasi A.Ll., në vitin 2005, ka dhënë huan në favor të babait të subjektit të rivlerësimit shumën prej 2,140,000 lekësh.

E pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të pasurisë së porositur nga babai i saj në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se<sup>38</sup> si burim për kryerjen e pagesës në favor të shoqërisë ndërtuese ka shërbyer edhe huaja pa interes e dhënë nga shtetasi A.Ll., në vlerën prej 2,140,000 lekësh.

Në vijim, e pyetur nga Komisioni nëse babai i saj e ka shlyer shumën prej 2,140,000 lekësh, të marrë hua nga shtetasi A.Ll., subjekti i rivlerësimit deklaroi se deri në maj të vitit 2009 është shlyer plotësisht kjo hua, me burim një pjesë nga të ardhurat e babait dhe një pjesë nga të ardhurat familjare të saj.

Për sa më sipër, bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara dhe në provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në informacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1994 – 2009, për të evidentuar mundësinë financiarë të z. A.Ll., për dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të pasqyruar në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza të ardhura/shpenzime me rezervë 1994-31.12.2009, familja Ll.,</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat I. Ll., <i>neto</i> nga statusi i veteranit (periudha 1.12.1994 – 30.5.2005)	315,122
Të ardhura I. Ll., (pjesa takuese nga shitja e pasurive të paluajtshme (periudha 12.2.1998 – 10.10.2006)	2,471,758
Të ardhura I. Ll, nga shitja e aksioneve (“***”, datë 20.6.2008)	225,000
Të ardhura të familjes nga shitja e apartamentit në Shkodër (datë 12.8.1996)	1,100,000
Të ardhura A. Ll., nga shitja e aksioneve (“***” sh.a., datë 2.6.2008)	45,000
Të ardhura nga dividenti i shpërndarë (“***” sh.a., vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2008)	29,892
Të ardhura nga dividenti i shpërndarë (“***” sh.a., vitet 1996, 2000, 2001 dhe 2002)	9,352
Të ardhura nga interesat bono thesari të Bankës së Shqipërisë (periudha 2002 – 2009)	978,035
Të ardhura nga interesat BKT (periudha 2002 – 2009)	297,253
Fitim <i>neto</i> 20 % të qarkullimit deklaruar në periudhën 1994 – 2008 (shuma e qarkullimit 14,425,066)	2,885,013
Të ardhura nga paga për periudhën 2005 – 2009, referuar AQS-së	806,724

<sup>33</sup> E-mail-i i datës 13.8.2018, administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe verifikimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar të kësaj shoqërie nga faqja zyrtare e QKB-së.

<sup>34</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 2.6.2008.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot.

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2019.

<sup>37</sup> Bazuar në vetëdeklarimin e subjektit.

<sup>38</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar me e-mail-in e datës 25.10.2019.

<b>Total të ardhura (1)</b>	<b>9,163,149</b>
Shpenzime për jetesë për periudhën 2000 – 2009 vetëm për A. Ll., INSTAT, ILDKPKI	<b>1,099,098</b>
Hua dhënë referuar kontratës në vlerën 45,000 euro	6,208,200
<b>Total dalje mjete monetare (2)</b>	<b>7,307,298</b>
<b>Rezultat (1-2)</b>	<b>1,855,851</b>

Për sa më sipër, konstatohet se personi tjetër i lidhur, z. A.Ll., ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

Në analizë të të gjitha provave të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit duket qartë që huadhënësi, z. A.Ll., dhe familja e tij kanë pasur një situatë të shëndetshme financiare – kjo si rrjedhojë e aktivitetit tregtar të huadhënësit, aksioneve që zotëronte huadhënësi dhe babai i tij në shoqëri të ndryshme tregtare, të ardhurat e përfituara nga z. I.Ll., si ish-i përndjekur politik, si dhe me burim shitjen dhe dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, në të cilat zotëronin pjesë takuese babai dhe nëna e huadhënësit.

Në këtë kuptim, në tabelën e mësipërme janë evidentuar vetëm të ardhurat e familjes Ll., të deklaruara si burim huaje nga huadhënësi (pa përfshirë pensionet apo të ardhura të tjera të mundshme) për të cilat dokumentohet pagesa e detyrimeve tatimore, duke sjellë në vëmendje faktin se huadhënësi dhe personat e lidhur me të nuk kanë qenë subjekte të deklarimit të pasurive, por edhe faktin se nga momenti i dhënies së huas ka kaluar një periudhë e gjatë kohe dhe mund të mos kenë treguar kujdesin e duhur për ruajtjen e plotë të dokumentacionit për të gjitha të ardhurat e përfituara ndër vite.

Nga shqyrtimi i të dhënave financiare të mësipërme - të para në një këndvështrim tjetër, duket se vetëm të ardhurat e z. A.Ll., të përlllogaritura nga Komisioni për periudhën deri para dhënies së huas, janë përafërsisht rreth 5,400,000 lekë (pa përfshirë të ardhurat e përfituara prej tij për periudhën janar - mars të vitit 2010), të cilat (duke përfshirë të ardhurat e përfituara për periudhën janar - mars të vitit 2010) janë të mjaftueshme për krijimin e një shume prej rreth 40,000 euro<sup>39</sup>. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, në vlerësim të informalitetit të kohës dhe të pretendimeve të huadhënësit për fitimin *neto* të realizuar nga aktiviteti i tij tregtar, si dhe duke konsideruar se shpenzimet e tij janë mbuluar nga familjarët me të ardhurat nga shitja apo dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, duket se ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të mbuluara me të ardhurat e përfituara prej tij.

Si përfundim, trupi gjykues krijoi bindjen e plotë se personi tjetër i lidhur, z. A.Ll., ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, për të mundësuar plotësisht dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

### *iii. Shuma 5,000,000 lekë, përfiturat nga kredia bankare*

Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 10.2.2011, e lidhur me “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a., në shumën prej 5,000,000 lekësh me të dhënat, si vijon: (i) qëllimi i marrjes së kredisë blerja e apartamentit të banimit; (ii) data e fillimit, 7.3.2011; (iii) data e mbarimit 7.3.2031; (iv) interesi aktual i kredisë 4 %; (v) kësti mujor (16 janar 2017) është në shumën 32,418.57 lekë; dhe (vi) detyrimi i mbetur, shuma prej 3,937,339.20 lekësh.

<sup>39</sup> Referuar kursit mesatar të këmbimit për vitin 2009, të publikuar në faqen e Bankës së Shqipërisë.

Lidhur me këtë kredi, subjekti ka depozituar (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): (i) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga BKT-ja; (ii) kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 10.2.2011; si dhe (iii) kontratën e hipotekimit nr. \*\*\*, datë 10.2.2011.

Deklarimi i kësaj kredie në vite: në DPV-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredinë e marrë në BKT, në shumën prej 5,000,000 lekësh, pagesat e kryera gjatë vitit, detyrimin e mbetur në fund të vitit dhe të gjitha të dhënat e tjera lidhur me këtë kredi. Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave periodike të dorëzuara ndër vite, nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI (vitet 2012 – 2016) konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesat vjetore të kryera lidhur me këtë kredi, si dhe detyrimin e mbetur në fund të çdo viti.

“Banka Kombëtare Tregtare”<sup>40</sup>, ndër të tjera, konfirmon se subjekti i rivlerësimit është kredimarrës në këtë bankë dhe se të dhënat e kredisë së sipërpërmendur pasqyrohen në tabelën, si më poshtë:

Shuma e disbursuar	Data e disbursimit	Vlera e mbetur	Data e maturimit	Dorëzanës	Kolaterali për sigurimin e kredisë
5,000,000 lekë	7.3.2011	3,508,115.61lek	7.3.2031	A.T.,	Apartament me nr. pasurie ***, vol. *** PG****, z. k. ***, në emër të shtetasve Elona dhe A. T.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje<sup>41</sup> rezulton se në datën 10.2.2011, subjekti i rivlerësimit ka lidhur me BKT-në kontratën e kredisë bankare sipas së cilës, banka ka akorduar në favor të kredimarrësit një total kreditimi në shumën 5,000,000 lekë.

Gjithashtu, rezulton se po në datën 10.2.2011 është lidhur kontrata e hipotekimit<sup>42</sup>, ku në cilësinë e hipotekuesit është shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila ka lënë si kolateral për garantimin e kësaj kredie apartamentin e porositur nga z. A.T., (bashkëshorti i subjektit), por të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në emër të shoqërisë në momentin e aplikimit të kredisë. Pjesë e dosjes së kredisë është edhe vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 10.1.2011, sipas të cilit kjo shoqëri i ofron si kolateral këtë pasuri.

Nga verifikimi i llogarisë bankare në BKT, në emër të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në datën 8.3.2011 është *disbursuar* në këtë llogari kredia në shumën prej 4,975,000 lekësh, shumë e cila ka kaluar në llogari të shoqërisë ndërtuese për shlyerjen e detyrimit të mbetur.

*iv. Shuma 1,980,000 lekë, përfituar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Tiranë*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se për çështjen me palë paditëse, z. A.T., palë të paditur Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, me objekt: “(1) detyrimin e të paditurit të paguajë dëmshpërblimin për zgjidhjen në mënyrë të njëanshme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, shpërblimin për vjetërsi në punë, pushimet vjetore të papaguara; dhe (2) dëmshpërblim të barabartë me një vit pagë, për arsye se kjo zgjidhje është bërë gjithashtu për një shkak të paarsyeshëm”, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- pranimin e padisë;
- detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me një shumë sa paga e një viti pune për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme;

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 6.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019.

<sup>41</sup> Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI dhe dokumentacioni i dërguar nga BKT-ja në ILDKPKI dhe Komision - lidhur me këtë kredi.

<sup>42</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 10.2.2011.

- detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit;
- detyrimin e të paditurit t'i paguajë paditësit shpërblimin për vjetërsi prej një muaji e gjysmë pagë, bazuar në nenin 145/1 të Kodit të Punës.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 20.3.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.4.2009 ka vendosur:

- lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 8.2.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë në lidhje me detyrimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të dëmshpërblejë paditësin me pagën e një viti pune për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, për të paguar pagën për dy muaj për mosrespektim të afatit të njoftimit, për të paguar për vjetërsi për një muaj e gjysmë pagë, për të paguar shpërblimin për pushim vjetor të vitit 2005;
- ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 8.2.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. \*\*\*, datë 20.3.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërimit të padisë së paditësit për detyrimin e palës së paditur për dëmshpërblim me pagën e një viti pune për zgjidhje të kontratës së punës, pa shkaqe të arsyeshme me motiv abuziv.

Referuar DPV-së së vitit 2009 konstatohet se në rubrikën “ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” subjekti ka deklaruar vlerën prej 2,000,000 lekësh, përfituar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.3.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i ASD-së, për t'i paguar bashkëshortit të subjektit dëmshpërblim për zgjidhje të kontratës (ekzekutuar datë 22.7.2009).

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje dhe llogarive të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk evidentohet kalimi i kësaj shume.

Në përgjigje të pyetësit nr. 2<sup>43</sup>, subjekti ka depozituar fotokopje të mandatit bankar nga “Raiffeisen Bank” të datës 22.7.2009, sipas të cilit bashkëshorti, z. A.T., ka tërhequr *cash* nga llogaria e zyrës së përbarimit Tiranë, shumën prej 1,749,312 lekësh.

Subjektit iu kërkua të konfirmojë vlerën *neto* të përfituar prej bashkëshortit, z. A.T., nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, duke e shoqëruar deklarinimin e saj me dokumentacion justifikues ligjor.

Në përgjigje të pyetësit të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegoi<sup>44</sup> se [...] në deklaratën “*Vetting*” është deklaruar shuma prej 1,980,000 lekësh (16 paga x 120,000 lekë/muaj), të përfituar nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 20.3.2006, ndërsa në DPV-në e vitit 2009 është deklaruar shuma 2,000,000 lekë, si shumatore e detyrimit të rrjedhur nga vendimi gjyqësor i sipërcituar, së bashku me shpenzimet gjyqësore dhe tarifën përbarimore, shumë e cila nuk u lërvua njëherësh. Prej shumës së sipërcituar, fillimisht, u tërhoq nga bashkëshorti i saj shuma prej 1,749,312 lekësh, në datën 22.7.2009, në “Raiffeisen Bank”, por kjo vlerë nuk përfaqëson të gjithë shumën e parashikuar në dispozitivin e vendimit të gjykatës. [...]. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në atë periudhë ekzekutimet e dëmshpërblimeve interpretoheshin në mënyrë të gabuar nga përbaruesit gjyqësor, duke i konsideruar si të ardhura

<sup>43</sup> Përgjigjet e dërguara me e-mail-in e datës 20.9.2019.

<sup>44</sup> Përgjigjet e pyetësit nr. 5, dërguar me e-mail-in e datës 20.11.2019.

të tatueshme në kuptim të ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe se fillimisht përmbaruesi gjyqësor i ka mbajtur 10 % të shumës në mënyrë të padrejtë. Pasi i kanë kërkuar përmbaruesit gjyqësor ekzekutimin dhe rimbursimin e shumës prej 10 %, ky i fundit në një moment tjetër nga ekzekutimi kryesor procedoi duke ekzekutuar plotësisht vendimin e gjykatës. Në lidhje me pjesën tjetër të shumës, subjekti ka deklaruar se nuk zotëron dokumentacion justifikues ligjor, ndonëse është përprjekur ta gjejë atë [...].

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se është deklaruar saktë shuma e përfituar nga bashkëshorti i subjektit në procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj ish-punëdhënësit të tij. Por, në mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për kalimin/ekzekutimin e plotë të kësaj shume në favor të bashkëshortit, në analizën financiare do të reflektohet vetëm shuma e identifikuar si e tërhequr me mandat bankar nga bashkëshorti i subjektit, referuar si më sipër.

### **Regjistrimi i kësaj pasurie/analiza e kontratës së sipërmarrjes dhe të shitjes**

**ZVRPP-ja Tiranë**<sup>45</sup>, ndër të tjera, informon se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë e llojit apartament me sip. 112.7 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me këtë pasuri konstatohet se në datën 18.9.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, z. A.T., kanë lidhur *kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme*<sup>46</sup> me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me objekt shitjen e pasurisë së llojit apartament me sip. të përgjithshme 135.32 m<sup>2</sup>, nga e cila sip. shfrytëzimi 112.7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe takuese në ambientet e përbashkëta 13.62 m<sup>2</sup>, sip. depo 4.5 m<sup>2</sup>, sip. verande të shfrytëzueshme 4.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të ndodhur në godinën e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në “\*\*\*\*” Tiranë, dhe kalimin e titullit të pronësisë së pasurisë nga shitësi të blerësi, me kushtet e parashikuara në kontratë<sup>47</sup>.

Në nenin 4 të kësaj kontrate, me titull “çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës” përcaktohet se palët bien dakord që çmimi i shitblerjes së pasurisë që përbën objektin e kësaj kontrate është: (i) vlera e apartamentit 135,000 euro; (ii) vlera e parkimit 12,000 euro. Gjithashtu, përcaktohet se pagesa është kryer nga blerësi të shitësi jashtë kësaj zyre noteriale dhe se palët nuk kanë pretendime për çmimin dhe mënyrën e pagesës.

Referuar kontratës së sipërmarrjes<sup>48</sup> së datës 31.7.2009 rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.T., ka porositur te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe ndërtimi total 130.82 m<sup>2</sup>, në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në “\*\*\*\*” Tiranë. Në nenin 3 të kësaj kontrate, me titull “çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës” përcaktohet se palët bien dakord që çmimi i ambientit objekt kontrate të jetë 135,000 euro, i cili do të paguhet me këste në mënyrë periodike sipas fazës së kryerjes së punimeve, si më poshtë:

i. porositësi ka paguar këstin e parë të blerjes të ambientit që prenotohet në vlerën 12,000 euro me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes;

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14. 2.2019.

<sup>46</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 18. 9.2012.

<sup>47</sup> Në këtë kontratë është përcaktuar dhe blerja e pasurisë së llojit garazh, pasuri e cila do të trajtohet në vijim të këtij vendimi.

<sup>48</sup> Kontrata e datës 31.7.2009, evidentuar në dosjen e kredisë, përcjellë nga BKT-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 28.6.2019.

- ii. porositësi do të paguajë këstin e dytë të çmimit të ambientit deri në datën 30.10.2009, në shumën 40,000 euro;
- iii. porositësi do të paguajë këstin e tretë të çmimit të ambientit deri në datën 31.3.2010, në shumën 50,000 euro;
- iv. porositësi do të paguajë këstin e fundit me marrjen në dorëzim të ambientit deri në datën 30.12.2010, në vlerën 33,000 euro.

### **Pagesat e kryera për blerjen e apartamentit, mënyra e kryerjes - analizë financiare**

Komisioni i kërkoi subjektit<sup>49</sup> të deklarojë duke konfirmuar se kur dhe në çfarë mënyre (*cash* apo me bankë) është likuiduar shuma prej 135,000 euro për apartamentin e sipërpërmendur, si dhe të rendisë në mënyrë kronologjike pagesat e kryera në favor të sipërmarrësit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>50</sup>: (i) pagesa e kështit të parë në shumën prej 12,000 euro u përmbush në datën 31.7.2009; (ii) pagesa e kështit të dytë në shumën prej 40,000 euro u përmbush në datën 9.11.2009; (iii) pagesa e kështit të tretë në shumën prej 50,000 euro u përmbush në datën 25.3.2010; dhe (iv) pagesa e kështit të katërt në shumën prej 33,000 euro u përmbush në datën 10.5.2011.

#### *a) Pagesa e kështit të parë*

Referuar deklarimit të subjektit, pagesa e kështit të parë në shumën prej 12,000 euro u përmbush në datën 31.7.2009 me të ardhurat: (i) 6,000 euro të tërhequra nga llogaria bankare e babait; (ii) 4,000 USD që u konvertuan në atë kohë në 2,800 euro, të tërhequra nga llogaria bankare e babait; dhe (iii) 3,200 euro nga kësti i parë 10,000 euro të dhëna hua nga z. A.LL., (duke i mbetur *cash* të papërdorura 6,800 euro).

Referuar DPV-së së vitit 2009 konstatohet se në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë” subjekti ka deklaruar se i ka marrë babait shumat që ka pasur në NBG në euro dhe në dollarë, përkatësisht shumën prej 6,000 euro dhe 4,000 USD.

Lidhur me huan e dhënë nga shtetasi A.LL., më sipër është bërë analiza e plotë e saj.

Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë së llojit apartament (objekt analize) shumat e marra nga babai i saj, të tërhequra nga llogaria bankare e tij.

Lidhur me këtë konstatim, nëpërmjet prapësimeve të sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se fakti i dhënies së shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD nga babai i saj është deklaruar në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës periodike vjetore të vitit 2009, vit në të cilin deklaroi se babai ia ka dhënë për kryerjen e pagesës së kështit të parë.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në përmbushje të detyrimit ligjor në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar rregullisht likuiditetet dhe burimet e krijimit të vlerave monetare që kanë shërbyer për pagesat e kësteve për blerjen e apartamentit dhe kjo tregon se mosdeklarimi në mënyrë të detajuar i vlerave të përdorura për pagesën e kështit të parë (6,000 euro + 4,000 USD + 3,200 euro) nuk është bërë me qëllim fshehjeje.

<sup>49</sup> Pyetësi nr. 2, dërguar me e-mailin e datës 10.9.2019.

<sup>50</sup> Përgjigjet e pyetësit nr. 2, dërguar nga subjekti me e-mail-in e datës 20.9.2019.

Subjekti i rivlerësimit pranon se nuk ka treguar kujdesin e duhur në plotësimin e deklaratës “Vetting”, pasi në këtë deklaratë ka paraqitur të gjitha burimet financiare që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të cilat ishin të materializuara në format kontraktore (kontratë kredie; vendim gjyqësor; kontratë shitjeje; kontratë huaje), duke mos cituar atë marrëdhënie specifike (baba/vajzë), e cila nuk ishte materializuar në formë të shkruar, por gjithsesi ishte rregullisht e deklaruar në ILDKPKI.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues. Është e vërtetë që në deklaratën “Vetting” subjekti nuk i ka deklaruar si burim krijimi të apartamentit shumat e marra nga babai për pagesën e kështit të parë në vitin 2009, por ndërkohë, në DPV-në vjetore të këtij viti e ka deklaruar qartësisht këtë fakt. Pasaktësia apo harresa e deklaratimit të këtij burimi në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk duket të jetë e qëllimshme nga subjekti, pasi trupi gjykues çmon se në këtë rast nuk ka pasur asgjë për të fshehur (fakti ishte deklaruar më parë) dhe madje i ka krijuar probleme në dukje të panevojshme në kuadër të këtij procesi, fakt i cili besohet se nuk ka qenë i dëshiruar nga subjekti. Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti ka sqaruar në mënyrë të detajuar dhe kronologjike të gjitha pagesat e kryera në favor të shoqërisë ndërtuese, duke vetëdeklaruar edhe pagesën e kështit të parë dhe burimin e krijimit të saj.

Në këtë kontekst, analiza e kësaj pasaktësie në deklarim merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive.

Si rrjedhim, trupi gjykues vlerëson se me rëndësi në këtë rast është evidentimi i burimit të krijimit, pra, vlerësimi i mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur për krijimin e këtyre shumave.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se referuar pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. K.S., (babai i subjektit) bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit, ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumave të dhëna vajzës së tij- që kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë, për blerjen e apartamentit.

Referuar deklarimeve periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, konstatohet se z. K.S., ka dhënë në favor të subjektit të rivlerësimit (si dhurime) edhe shuma të tjera. Shumat e dhëna/të dhuruara nga babai i subjektit, të deklaruara ndër vite, pasqyrohen në tabelën, si më poshtë:

Viti	Shuma e dhuruar në lekë	Shuma e dhuruar në euro	Shuma e dhuruar në USD	Qëllimi i dhurimit
2008	150,000	0	0	Dhuratë fëmijëve
2009	0	6,000	4,000	Për blerje apartamenti kësht 1
2010	150,000	0	0	Dhuratë fëmijëve
2012	200,000	0	0	Llog. dep. fëmijët dhe kësht kredi
2013	100,000	0	0	Dhuratë fëmijëve
2014	150,000	0	0	Dhuratë fëmijëve
2016	200,000	0	0	Dhuratë fëmijëve
<b>Totali</b>	<b>950,000</b>	<b>6,000</b>	<b>4,000</b>	

- *Analizë e burimit të krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. K.S.*



Në lidhje me analizën e burimit të të ardhurave për vlerat monetare të dhëna për pagesën e këstit të parë të apartamentit, konkretisht në vlerën 6,000 euro dhe 4,000 USD, në datën 31.7.2009 u shqyrtuan deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacioni përkatës i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

Referuar të dhënave nga “ABI”<sup>51</sup> rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur llogari bankare në bankën NBG, në monedhën lekë, dollarë dhe euro: (a) llogaria në ALL është hapur më 20.11.2008, me një derdhje *cash* në vlerën 270,000 lekë, e cila pasi ka kaluar në depozitë me afat është tërhequr në datën 20.7.2009; (b) llogaria në dollarë është hapur në datën 6.9.2007, me një derdhje *cash* në vlerën 1,900 USD, si dhe në datën 20.11.2008 është kredituar me shumën 2,000 USD. Këto shuma kanë kaluar në depozitë me afat dhe në datën 20.7.2009 është tërhequr *cash* shuma prej 3,960 USD; (c) llogaria në euro është hapur më 6.9.2007, me një derdhje *cash* në llogari në vlerën 4,000 euro, shumë e cila ka kaluar në depozitë me afat. Gjendja në këtë depozitë, në datën 31.12.2008, ka qenë në vlerën 6,000 euro. Në datën 20.7.2009 është tërhequr *cash* shuma 6,072 euro.

Për sa më sipër, rezulton se në datën 20.7.2009 (10 ditë përpara pagesës së këstit të parë të apartamentit), babai i subjektit të rivlerësimit ka zotëruar likuiditetet, duke dokumentuar prejardhjen e vlerave 6,000 euro dhe 4,000 USD, sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti i rivlerësimit, për kryerjen e pagesës së këstit të parë.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e këtyre shumave, *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se janë të ardhura të krijuara nga prindërit e saj*. Ndërsa, për të justifikuar vlerat monetare të dhuruara *cash* apo të depozituara në llogari të fëmijëve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues në Komision: vërtetim nga ISSH-ja për përfitim pensioni pleqërie dhe suplementar që nga viti 1991, vlera totale 6,259,858 lekë; dhe deklaratë noteriale të shtetasit E. T., sipas së cilës *deklaroi se ka pasur me qira apartamentin në pronësi të subjektit dhe babait të saj për periudhën 1.10.2006 – 31.8.2009, kundrejt vlerës mujore 20,000 lekë/muaj dhe se është shlyer nga qiramarrësi çdo detyrim tatimor*. Shumat, referuar kësaj deklarate, janë: (i) për vitin 2006, vlera 60,000 lekë; (ii) për vitin 2007, vlera 240,000 lekë; (iii) për vitin 2008, vlera 240,000 lekë dhe për vitin 2009, vlera prej 160,000 lekësh.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>52</sup> informon se nga verifikimi i kryer në librat e kontabilitetit rezulton se shtetasi E. T., me NIPT \*\*\* ka kryer pagesa të tatimit mbi qiranë për periudhën 1.10.2006 – 31.8.2009, duke sqaruar se të gjitha pagesat e kryera nuk janë të specifikuar në përkrahim apo të deklaruar se cilës kontrate i takon pagesa e tatimit në burim, si dhe pa përcaktuar vlerën e tatimit të paguar.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se babai i saj ka përfituar të ardhura nga qiradhënia e kësaj banese në vitin 2005 shtetasit E. Gj., (në total për shumën prej 220,000 lekësh), por nuk ka depozituar dokumentacion provues për pagesën e tatimit në burim dhe se DRT-ja Tiranë<sup>53</sup> informon se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar pagesat e tatimit në burim.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë<sup>54</sup> konfirmon se z. K.S., trajtohet me pension pleqërie nga data 16.1.1991 e në vazhdim, si dhe me pension suplementar nga data 1.7.2009, duke pasqyruar edhe vlerat e përfituara sipas periudhave përkatëse.

<sup>51</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019.

<sup>52</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019.

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2019.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni evidentoi se z. K.S., në datën 20.10.2004, ka porositur<sup>55</sup> pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 78 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, për vlerën prej 51,000 euro, pasuri për të cilën është nënshkruar kontrata e shitjes<sup>56</sup> në datën 26.4.2013.

Referuar kontratës së porosisë të lidhur ndërmjet z. K.S., në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, në seksionin IV të saj përcaktohet mënyra e pagesës, si vijon: (a) me lidhjen e kontratës porositësi është i detyruar të paguajë këstin në vlerën 8,700 euro; (b) brenda nëntorit të vitit 2004, porositësi detyrohet të paguajë këstin e dytë prej 6,300 euro; (c) brenda janarit të vitit 2004 (sipas subjektit është gabim material dhe duhet muaji janar 2005 në konsideratë të faktit se kontrata është lidhur në datën 20.10.2004) porositësi detyrohet të paguajë këstin e tretë prej 30,000 euro; dhe (ç) me marrjen në dorëzim të vërtetimit të pronësisë nga ZRPP-ja Tiranë të apartamentit, porositësi detyrohet të paguajë këstin e fundit në shumën prej 6,000 euro.

Ndërsa referuar deklaramentit të subjektit<sup>57</sup>, në përmbushje të detyrimit sa më sipër, pagesat në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., janë kryer, si vijon: (i) kësti i parë në vlerën 8,700 euro u pagua me lidhjen e kontratës në datën 20.10.2004; (ii) kësti i dytë në vlerën 6,300 euro u pagua në datën 14.11.2004; (iii) kësti i tretë në vlerën 31,000 euro u pagua në datën 28.1.2005; dhe (iv) kësti i fundit<sup>58</sup> në vlerën 5,000 euro u pagua në datën 26.4.2013, pasi në datën 11.4.2013, shoqëria u pajis me certifikatë pronësie të lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues katër mandatpagesa, të cilat referojnë pagesat e kryera në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

E pyetur nga Komisioni për burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga puna private dhe pensioni i babait; (ii) të ardhurat nga puna private dhe pensioni i nënës; (iii) pagat dhe shpërblimet e saj për periudhën prill 1995 – tetor 2000 (para martesë); (iv) shuma prej 700,000 lekësh nga tërheqja e bonove të thesarit të krijuara me të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit; si dhe (v) shuma prej 2,140,000 lekësh hua e dhënë pa interes nga shtetasi A.Ll.

Subjekti pretendon se për periudhën para blerjes së kësaj pasurie, familja ka pasur edhe të ardhura të tjera, të cilat për mungesë dokumentacioni i deklaroi me rezervë, si vijon: (i) të ardhura të përfituara prej nënës nga shoqëritë “\*\*\*” dhe “\*\*\*”, duke pretenduar se ka arritur të tërheqë të gjitha shumtë e investuara në këto shoqëri dhe interesat përkatëse; (ii) të ardhurat nga bursa e fituar prej saj për studimet e kryera në vitin akademik 1992 – 1993, në masën 7,000 lekë/muaj; (iii) bursa e fituar prej saj për studimet e kryera në vitin akademik 1993 – 1994, në masën 1,400 lekë/muaj; dhe (iv) shumtë e përfituara prej saj si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Ekonomisë, lënda e Drejtë Biznesi, në vitin akademik 1994 – 1995.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>59</sup> [...] babai i saj, z. K.S., si ushtarak ka dalë në pension në fillim të vitit 1991, në moshën 55 vjeç. Si shumë ushtarakë që filluan në këto vite (1992–1994) të punonin në shoqëri sigurimi, kambizmi, tregti etj., babai i saj në fundvitin 1993, ka filluar punë në kompaninë private të sigurimit të objekteve “\*\*\*” sh.p.k., (sot “\*\*\*.”), ndërsa nëna pranë një bar-kafeje që nga viti 1994, regjistruar në emër të shtetasis V. Zh., me NIPT \*\*\* [...].

<sup>55</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 20.10.2004.

<sup>56</sup> Kontratë nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2013.

<sup>57</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 6, dërguar nga subjekti me e-mail-in e datës 10.12.2019.

<sup>58</sup> Subjekti sqaron se pavarësisht se kësti i fundit ka qenë i përcaktuar në kontratë në shumën prej 6,000 euro, për faktin që kësti i dytë ka qenë i përcaktuar në kontratë në vlerën 30,000 euro dhe u paguan 31,000 euro, kësti i fundit për t'u paguar mbeti në vlerën 5,000 euro.

<sup>59</sup>Përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar me e-mail-in e datës 25.10.2019.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues shkresën e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., sipas së cilës kjo shoqëri konfirmon se ndërmjet saj dhe z. K.S., ka qenë e lidhur një kontratë pune me kohë të pjesshme pa afat. Kontrata ka filluar nga data 5.12.1993 dhe ka zgjatur deri në datën 30.11.2002. Detyra që ka kryer z. K.S., ka qenë ajo e përgjegjësit të kontrollit të rojeve të punësuar nga shoqëria, duke informuar se përgjatë periudhës së sipërpërmendur është paguar me honorare, si më poshtë:

Viti	Pagesa mujore në lekë	Pagesa vjetore në lekë
1993	5,500	5,500
1994	5,500	66,000
1995	8,000	96,000
1996	10,000	120,000
1997	12,000	144,000
1998	12,000	144,000
1999	13,000	156,000
2000	13,000	156,000
2001	14,000	168,000
2002	14,000	154,000
<b>Totali</b>		<b>1,209,500</b>

Referuar kësaj shkrese, përfaqësuesi i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaroi se për shkak të tejkalimit të periudhës së parashikuar në nenin 21 të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, dokumentacioni nuk është ruajtur përtej këtij afati, prandaj nuk mund ta vendosë në dispozicion. Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues kopje të printuara të ekstraktit historik të regjistrit tregtar për të dhënat e shoqërisë, nga faqja zyrtare e QKB-së, sipas të cilit evidentohet se kjo shoqëri është themeluar në datën 10.8.1993 dhe është regjistruar në gjykatë në datën 14.8.1993.

Gjithashtu, subjekti pretendon se<sup>60</sup> nëna e saj, e ndjera znj. H.S., nga puna si banakiere në lokalitetin e shtetasit V.Zh., me emër tregtar “\*\*\*\*” të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për periudhën maj 1994 – dhjetor 2000, ka përfutur të ardhurat nga paga në total shumën prej 1,064,000 lekësh. Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti ka depozituar si provë: (i) deklaratë noteriale të shtetasit V.Zh.; (ii) ekstrakt historik i regjistrit tregtar nxjerrë nga QKB-ja për subjektin “\*\*\*\*”, Person Fizik me NIPT \*\*\*, me aktivitet “bar kafe”; si dhe (iii) dy fotografi të nënës nga vendi i punës.

Sikurse evidentuam më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat familjare (nga paga e saj dhe e bashkëshortit) kanë shërbyer për kthimin e huas së dhënë nga z. A.Ll., në favor të z. K. S. Në vijim të deklaratimit, subjekti ka shpjeguar se krahas mardhënies së posaçme, kjo ka qenë arsyeja se pse babai i saj i ka dhënë shumat për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, vlerën e plotë të shitjes së apartamentit në Rr. “\*\*\*\*” apo ka kontribuar në shtimin e llogarisë bankare të fëmijëve. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në kushtet kur si garant për dhënien e kësaj huaje, pa interes, ka qenë bashkëshorti, si mik i ngushtë i z. A.Ll., nisur nga korrektësia e treguar prej tyre në kthimin e kësaj huaje, ky i fundit pranoi t’i ndihmonte dhe t’i jepte huan në vitin 2009, por në këtë rast, me këmbënguljen e bashkëshortit të saj, u vendos që kthimi i huas të bëhej me pagesë interesash në përfundim të likuidimit total të saj<sup>61</sup>.

<sup>60</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar me e-mail-in e datës 25.10.2019.

<sup>61</sup> Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. 6, dërguar me e-mail-in e datës 10.12.2019.

Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja<sup>62</sup> (llogaria rrjedhëse nr. \*\*\*) konfirmohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.T., për periudhën 2005 – 2009 ka transferuar në total shumën 2,020,000 lekë, në favor të shtetasit A.Ll., me përshkrimin “likuidim/shlyerje detyrimi/borxhi”, të pasqyruara të ndara sipas viteve dhe shumave përkatëse të transferuara, si vijon: (i) për vitin 2005 ka transferuar shumën prej 300,000 lekësh; (ii) për vitin 2007 ka transferuar shumën prej 450,000 lekësh; (iii) për vitin 2008 ka transferuar shumën prej 970,000 lekësh; dhe (iv) për vitin 2009 ka transferuar shumën prej 300,000 lekësh.

Bazuar në të dhënat e vetëdeklaruara dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në informacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë – me rezervë (të ardhura/shpenzime) për periudhën 1.4.1991–31.7.2009, për të evidentuar mundësinë e z. K.S., për dhënien e shumave në favor të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit objekt hetimi, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza financiare – me rezervë, periudha 1.4.1991-31.7.2009 (K.S.)</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat e babait nga pensioni 1.4.1991– 31.7.2009	1,911,809
Të ardhura të nënës nga pensioni	439,359
Të ardhura nga SHPSF-ja, babai 1993 – 2002 (shkresë nga shoqëria )	0
Të ardhura nga paga <i>neto</i> E. S., periudha 1995 – 31.10.2000	1,234,609
Të ardhura nga qiradhënia 1.10.2006 – 31.7.2009 (qiramarrës E. T., )	680,000
Të ardhura nga qiradhënia 2005 – 1.10.2006 (qiramarrës E. Gj., )	0
Të ardhura nga punësimi i nënës pranë subjektit V. Zh., (deklaratë noteriale, foto nga vendi i punës)	0
Dhurime nga subjekti i rivlerësimit (deklaruar)	700,000
Transferime nga bashkëshorti për likuidim huaje ndaj shtetasit A. Ll., 2005 – 2009, nga llogaria rrjedhëse në BKT (ekstrakt bankar BKT)	2,020,000
Të ardhura të tjera interesa bono + interesa NBG	172,020
<b>Total të ardhura (1)</b>	<b>7,157,797</b>
Dhurime për blerje apartamenti për subjektin	1,228,773
Pagesë shpenzime jetese 2001 – 31.7.2009, 1 person, INSTAT, ILDKPKI	934,173
<b>Shpenzime total (2)</b>	<b>2,162,946</b>
Blerje apartamenti Rr. “***” (referuar kontratës së datës 20.10.2004, shuma 51,000 euro)	6,430,080
Detyrime 5,000 euro	630,400
<b>Pasuri <i>neto</i> (3)</b>	<b>5,799,680</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2-3)</b>	<b>- 804,829</b>

Për sa më sipër, në konsideratë të investimit të kryer për blerjen e apartamentit në vitin 2004, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për dhënien e shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD, të cilat sipas vetëdeklarimit të subjektit kanë shërbyer për likuidimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit.

Me prapësimet e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, por edhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se babai (familja e saj) ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhënien e

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019.

shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD në favor të saj, për kryerjen e pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit.

Subjekti i rivlerësimit fokusohet kryesisht te të ardhurat e përfituara nga prindërit nga puna e tyre e ligjshme, babai si punonjës në kompaninë private të sigurimit dhe nëna nga puna si banakiere, duke kërkuar nga Komisioni të ketë një qasje elastike në këtë drejtim, në përputhje me parimin e objektivitetit dhe të proporcionalitetit, në vlerësimin e provave të depozituara prej saj, si dhe në këndvështrim të informalitetit të kohës.

Pasi shqyrtoi me objektivitet dhe paanësi provat e depozituara dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se disa të ardhura të pretenduara si të përfituara nga puna e kryer e babait dhe nënës së saj nuk janë të dokumentuara në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se:

a. Bazuar në nenin 246, të Kodit të Procedurës Civile, shkresa e shoqërisë “\*\*\*.” sh.p.k., merr fuqi provuese për efekt të këtij procesi - për sa kohë që gjen mbështetje dhe harmonizohet me të dhënat e informacionet e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer.

b. Si një nga mjetet për kërkimin e provës, në kuptim të germës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, deklarimi i dhënë nga ish-punëdhënësi i nënës merr vlerë provuese të rëndësishme, i kombinuar me *indicie* të tjera të punësimit, siç janë fotografitë nga vendi/posti i punës, të depozituara si prova nga subjekti.

c. Kjo situatë duhet parë në këndvështrim të informalitetit të kohës, faktit se këta dy shtetas nuk kanë pasur ndonjëherë funksione shtetërore të tilla që mund t’i bënin subjekte deklarues në të ardhmen, si dhe faktit se legjislacioni fiskal në Shqipëri ngarkon punëdhënësin të kryejë rolin e agjentit tatimor për mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga pagat.

d. Vërtetë pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ndër të tjera, parashikon se pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, por kjo dispozitë duket se lidhet direkt dhe ngushtësisht me të ardhurat dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur më të.

Si rrjedhim, Komisioni çmon se vlerësimi i këtyre të ardhurave të pretenduara duhet bërë duke mbajtur në konsideratë faktet e analizuara më sipër, si dhe duke u trajtuar në harmoni me provat dhe shpjegimet e depozituara nga subjekti.

Në këtë këndvështrim, në dritën e rrethanave të evidentuara si më sipër, fakteve dhe provave të depozituara nga subjekti, Komisioni vëren se edhe sikur këto të ardhura të pretenduara nga punësimi të mos të reflektohen në rubrikën e të ardhurave, mjafton që të vlerësohen se kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe në këtë rast analiza financiare do të rezultonte me balancë pozitive fondesh.

Në këtë kontekst, gjithashtu mund të supozohet se nga tërësia e të ardhurave të pretenduara/të dokumentuara si të përfituara, ndër vite, nga babai dhe nëna e subjektit, të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga z. K.S., nga puna në shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., dhe të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga znj. H.S., nga puna si banakiere në bar-kafenë “\*\*\*” mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve apo pagesat e kryera për blerjen e apartamentit të porositur në vitin 2004 nga babai i subjektit, duke mos cenuar në vetvete ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat mund të kenë shërbyer për dhënien e shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD në favor të subjektit të rivlerësimit, të

cilat mund të gjejnë mbulim nga të ardhurat e tjera të përfituara prej tyre, ndër vite, të provuara me dokumentacion justifikues ligjor.

Në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit<sup>63</sup>, Komisioni vlerëson se për sa kohë personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete dhe rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.

Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet përpara situatës së parashikuar prej pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.

Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, i cili nuk figuron të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur.

Si përfundim, referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, si dhe në mungesë të *indicieve* të besueshme për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumave 6,000 euro dhe 4,000 USD të dhëna në favor të subjektit, me qëllim kryerjen e pagesës së këstit të parë për blerjen e apartamentit objekt hetimi.

Gjithashtu, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të z. K.S., për kryerjen e dhurimeve të tjera në favor të subjektit të rivlerësimit (kreditimi i llogarive bashkëmore me fëmijët e saj), mbështetur në një qasje proporcionale të pasurisë objekt interesi, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë (të ardhura/shpenzime) për periudhën 1.8.2009 – 31.12.2016, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën, si më poshtë:

<b>Analiza financiare periudha 1.8.2009 - 31.12.2016 (K.S.)</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma në lekë</b>
Të ardhurat nga pensioni i pleqërisë 1.8.2009 – 2016	2,050,547
Të ardhura nga pensioni suplementar 1.8.2009 – 31.12.2016	1,002,737
Të ardhura nga qiradhënia 1.8.2009 – 31.8.2009 (qiramarrës E. T.,)	20,000
<b>Total të ardhura (1)</b>	<b>3,073,284</b>
Pagesë kësti i fundit për apartamentin në vlerën 5,000 euro, në vitin 2013 (referuar kontratës së shitjes datë 26.4.2013)	701,050
Dhurime për llogari të fëmijëve të subjektit (nipërve të tij), 2010 – 2016	800,000
Pagesë shpenzime jetese datë 1.8.2009 – 2016 , 1 person, INSTAT, ILDKPKI	1,290,103
<b>Shpenzime total (2)</b>	<b>2,791,153</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>282,131</b>

<sup>63</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019 dhe nr. 20/2019 (JR), datë 31.7.2019.

Referuar analizës financiare të mësipërme, konstatohet se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit të rivlerësimit) ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shumat e dhuruara për subjektin e rivlerësimit/nipërit e tij, të deklaruara ndër vite.

*b) Pagesa e këstit të dytë*

Referuar deklaramit të subjektit, pagesa e këstit të dytë në vlerën 40,000 euro u përmbush në datën 9.11.2009, me burim të ardhurash: (1) 39,210 euro nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi të subjektit me babanë; dhe (2) 790 euro nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me kontratën e shitblerjes së datës 4.9.2009, finalizoi shitjen e apartamentit që kishte në bashkëpronësi me babanë në shumën prej 5,800,000 lekësh, nga të cilat: vlera prej 381,056 lekësh u pagua në ZVRPP-në Tiranë, si tatim për kalimin e pasurisë; dhe shuma prej 5,418,944 lekësh (që në atë ditë konvertohej në shumën prej 39,210 euro) është depozituar në llogari.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se meqenëse afati i likuidimit të këstit të dytë ishte data 30.10.2009, e kaluan shumën e mësipërme në depozitë dymujore, në mënyrë që gjatë kësaj kohe të shtonin me kursimet e tyre pjesën e mbetur (shumën 790 euro) për të plotësuar shumën prej 40,000 euro të këstit të dytë, i cili u shlye në datën 9.11.2009, pra, 9 ditë me vonesë nga data e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, për shkak të afatit të mbylljes së depozitës.

Nga analizimi i informacionit të dërguar nga BKT-ja<sup>64</sup> lidhur me llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në datën 8.9.2009, në llogarinë me nr. \*\*\* është depozituar shuma prej 5,800,000 lekësh dhe se po në datën 8.9.2009 është tërhequr shuma prej 500,000 lekësh. Ndërkohë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se është kryer pagesa e tatimit mbi shitjen në shumën prej 381,056 lekësh.

Në vijim të analizimit të llogarisë së mësipërme rezulton se në datën 9.9.2009, bashkëshorti i subjektit, z. A.T., depoziton shumën 100,000 lekë dhe se po në këtë datë krijon depozitën në shumën prej 5,400,000 lekësh. Në datën 28.9.2009, në këtë llogari depozite është depozituar shuma prej 60,000 lekësh. Në datën 9.11.2009 është *maturuar* depozita dymujore dhe në total, gjendja në këtë llogari është në shumën 5,565,247 lekë. Nga kjo shumë, vlera prej 5,554,584 lekësh, pasi është konvertuar në euro është transferuar në llogarinë në euro të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në BKT (llogaria nr. \*\*\*), vlera totale 40,120 euro. Po në datën 9.11.2009, shuma prej 40,000 euro transferohet në favor të përfaqësuesve të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “detyrim kontraktor”.

Për sa më sipër, nga hetimi i kryer konfirmohet se pagesa e këstit të dytë në shumën prej 40,000 euro është përmbushur nëpërmjet transfertës bankare në datën 9.11.2009.

*c) Pagesa e këstit të tretë*

Referuar deklaramit të subjektit, pagesa e këstit të tretë në shumën prej 50,000 euro është përmbushur në datën 25.3.2010, me burim të ardhurash: (1) shumën prej 32,500 euro pjesë e këstit të dytë të kontratës së huas; (2) shuma prej 2,500 euro e dhënë *cash* nga z. A.Ll., si pjesa e këstit të dytë të kontratës së huas; (3) shumën prej 1,947,089 lekësh nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor; si dhe (4) shumën prej 150,661 lekësh nga mbylljet e llogarive.

---

<sup>64</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në datën 24.3.2010, në llogarinë bankare të bashkëshortit, z. A.T., në BKT, është transferuar shuma prej 4,500,000 lekësh (që me kursin e ditës konvertohej në vlerën 32,500 euro), si ekzekutim i kështit të dytë të kontratës së huas dhe se po në këtë datë iu dha nga z. A.Ll., diferenca prej 2,500 euro.

Në vijim, subjekti shpjegon se shumës prej 4,500,000 lekësh, në të njëjtën llogari iu shtuan lekët e ekzekutimit të vendimit gjyqësor (të sipërpërmendur) në shumën prej 1,947,089 lekësh dhe 150,661 lekë, nga mbylljet e katër llogarive bankare. Shuma totale në llogari arriti vlerën 6,597,750 lekë, e cila me kurs preferencial u konvertua në vlerën 47,500 euro. Kësaj shume iu shtuan edhe 2,500 euro të dhëna *cash* nga z. A.Ll., dhe në datën 25.3.2010 u pagua kësti i tretë në favor të shoqërisë, në shumën prej 50,000 euro.

Siç e kemi evidentuar edhe më sipër, në datën 22.7.2009, bashkëshorti i subjektit, z. A.T., ka tërhequr *cash* në “Raiffeisen Bank” nga llogaria e zyrës së përmbartimit Tiranë, shumën prej 1,749,312 lekësh.

Nga verifikimi i llogarive bankare në BKT rezulton se në datën 22.7.2009, në llogarinë depozitë në lekë me nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortit të subjektit, është depozituar *cash* shuma prej 1,500,000 lekësh. Në këtë llogari janë kryer edhe transaksione të tjera, kreditime nëpërmjet depozitimit të shumave *cash* apo të transferuara nga llogari të tjera të tij, duke i investuar në depozita të reja me afate të ndryshme *maturimi*. Në datën 24.2.2010, pas *maturimit* dhe kthimit të tri prej depozitave është investuar në një depozitë të re shuma prej 1,942,395 lekësh. Në vijim, në datën 15.3.2010, shuma prej 1,942,395 lekësh është transferuar në llogarinë në lekë me nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortit të subjektit. Në të njëjtën llogari, pas *maturimit*, në datën 15.3.2010 janë transferuar dhe shumat e tri depozitave të tjera, në total për vlerën 131,986 lekë. Pas gjithë këtyre transaksioneve llogaria me nr. \*\*\* është mbyllur.

Gjithashtu, konstatohet se në llogarinë në lekë me nr. \*\*\*, në BKT, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A.T., në datën 24.3.2010, është transferuar shuma prej 4,500,000 lekësh nga z. A. Ll., me përshkrimin “dhënie huaje sipas kontratës”.

Në datën 24.3.2010, gjendja e llogarisë në lekë me nr. \*\*\* është në vlerën prej 6,597,750 lekësh, ku përfshihen: (i) shumat e 4 depozitave të transferuara më parë nga llogaria në lekë me nr. \*\*\* (depozita në vlerën 1,947,089 lekë dhe tri depozitat e tjera me vlerë, në total 131,984 lekë); (ii) shuma prej 4,500,000 lekësh e transferuar nga shtetasi A.Ll., si pjesë e kontratës së huas; si dhe (iii) shuma prej 18,860 lekësh, e kaluar në këtë depozitë nga llogaria rrjedhëse e bashkëshortit të subjektit.

Po në datën 24.3.2010, shuma prej 6,597,750 lekësh, pasi është konvertuar në shumën 47,500 euro, është transferuar në llogarinë në euro në BKT (nr. \*\*\*), në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Në datën 25.3.2010, z. A.T., ka depozituar *cash* në këtë llogari shumën prej 2,607 euro dhe se po në të njëjtën datë ka transferuar shumën prej 50,000 euro në favor të përfaqësuesve të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “likuidim sipas kontratës”.

Për sa më sipër, nga hetimi i kryer konfirmohet se pagesa e kështit të tretë në shumën prej 50,000 euro është përmbushur nëpërmjet transfertës bankare në datën 25.3.2010.

#### d) Pagesa e kështit të katërt

Referuar deklaratimit të subjektit, pagesa e kështit të katërt në shumën prej 33,000 euro është përmbushur në datën 10.5.2011, me burim të ardhurat e përfituara nga kredia bankare në vlerën prej 5,000,000 lekësh.



Siç evidentuam edhe më sipër, nga verifikimi i llogarisë bankare, në emër të subjektit të rivlerësimit në BKT (llogari në lekë me nr. \*\*\*), konstatohet se në datën 8.3.2011 është *disbursuar* kredia në shumën prej 4,975,000 lekësh.

Në datën 10.5.2011, shuma prej 4,959,300 lekësh, gjendje në llogarinë e mësipërme, pasi është konvertuar në shumën prej 34,900 euro është transferuar në llogarinë në euro në BKT (nr. \*\*\*), në emër të subjektit të rivlerësimit.

Po në datën 10.5.2011, shuma prej 33,000 euro është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*”, me përshkrimin “likuidim kësti për blerje apartamenti sipas kontratës së sipërmarrjes datë 31.7.2009”.

Për sa më sipër, nga hetimi i kryer konfirmohet se pagesa e këstit të katërt në shumën prej 33,000 euro është përmbushur nëpërmjet transfertës bankare në datën 10.5.2011.

### **Konkluzione lidhur me pasurinë objekt vlerësimi**

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, lidhur me pasurinë e llojit apartament banimi objekt hetimi, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe analizës financiare<sup>65</sup> të kryer për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshorti) kanë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri, si dhe kanë pasur aftësi paguese nga burime financiare të ligjshme, për kryerjen e pagesave përgjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, për blerjen e saj.

### **27. Pasuria e llojit apartament<sup>66</sup> me sip. 85.7 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*” Vlorë, në bashkëpronësi me bashkëshortin.**

Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar:

i. kontratën e shkëmbimit të truallit me sip. 2,500 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2013, dorëzuar në korrik të vitit 2014, e paregjistruar në ZVRPP; dhe

ii. konvertimin e një pjese të sipërfaqes dhe mobilimin e banesës me vlerë monetare 8,000 euro nga babai i bashkëshortit, z. I.T., që ka si burim të ardhurat e krijuara nga pasuritë e paluajtshme në pronësi të tij.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

ZVRPP-ja Vlorë<sup>67</sup> konfirmon se në emër të shtetasit A.T., (bashkëshorti i subjektit) figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 78.7 m<sup>2</sup>, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë dhurimi.

<sup>65</sup> Referuar analizës së treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, konstatohet se për periudhën 2003 – 2011 paraqitet me balancë pozitive të fondeve për çdo vit të analizuar më vete.

<sup>66</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* dhe aneks \*\*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): (1) kontratë për shkëmbim trualli nr. \*\*\*, datë 7.10.2013, bashkëlidhur saj: vendimi i KKKPP-së nr. \*\*\*, datë 27.7.1995, vërtetim pronësie datë 12.7.1996, leje ndërtimi e shoqërisë “\*\*\*\*” dhe shoqërisë “\*\*\*\*”, deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 16.3.2013, formular i lejes së ndërtimit dhe vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 12.7.1996; (2) lidhur me të ardhurat dhe kontributin financiar të dhënë z. I.T., ka depozituar dokumentacionin, si vijon: (i) vërtetim pronësie i vitit 1991 sipas të cilit konfirmohet se prona e ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, figuron e regjistruar në datën 28.12.1970, në favor të shtetit kundër z. S.T.; (ii) vërtetim pronësie datë 10.11.1995, për truallin e parë me sip. 337 m<sup>2</sup> dhe truallin e dytë me sip. 143 m<sup>2</sup>, pronë e cila është regjistruar me vendimin e KKKP-së nr. \*\*\*, datë 17.8.1995 dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 28.10.1995; (iii) vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 3.7.1998; (iv) kontratë qiraje lidhur në datën 1.12.1995; (v) prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 30.9.1998; (vi) kontratë qiraje lidhur në datën 30.6.1998; (vii) kontratë qiraje lidhur në datën 1.7.2000; (viii) kontratë shitblerjeje pasurie datë 20.12.2001.

<sup>67</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2019.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Vlorë, konstatohet se nëpërmjet kontratës së dhurimit<sup>68</sup> datë 28.7.2018, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., i dhuron shtetasit A.T., pasurinë e llojit apartament me sip. 78.7 m<sup>2</sup>, sip. të përbashkët 9.8 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e ndodhur në Vlorë, me indeks harte \*\*\*.

Në nenin 3 të kësaj kontrate përcaktohet se shkak i dhurimit të pasurisë në favor të z. A.T., bëhet për efekt të ekzekutimit të kontratës së shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 7.10.2013 dhe sjelljen e pasojave ligjore, transferimin e së drejtës së pronësisë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., te z. A.T.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>69</sup>, lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se [...]me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.7.1995 të Komisionit të Kthimit të Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të Bashkisë Vlorë, ndërmjet të tjerave, në favor të bashkëpronarëve të familjes Toro është vendosur njohja e një sipërfaqeje prej 5,100 m<sup>2</sup> e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*” (ish-“\*\*\*\*”), nga e cila 2,500 m<sup>2</sup> e kthyer fizikisht, sipërfaqe kjo e regjistruar në zyrën e hipotekës Vlorë, në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 12.7.1996. Në vijim shpjegon se pa dijeninë dhe lejen nga bashkëpronarët Toro, në mënyrë të paligjshme, nga të tretë kishte filluar të ndërtohej një objekt. Këto punime u bënë shkak që pronarët të investonin Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila vendosi: detyrimin e të paditurit (K.C.) të lirojë e dorëzojë truallin me sip. 1,300 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, vendim i lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. \*\*\*, datë 18.4.2006 dhe në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.7.2007. Pavarësisht sa më sipër, KRRT-ja Bashkia Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.9.2010, ka pajisur me leje ndërtimi shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin e një pike karburanti dhe godine 4 kate polifunkionale. Për këtë vendim, familja Toro investoi edhe një herë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila në vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2011 ka vendosur shfuqizimin e aktit administrativ, vendimi nr. \*\*\*, datë 7.9.2010 i KRRT-së Bashkia Vlorë, vendim i lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ndodhur në një situatë të tillë, përballë qëndresës së investitorëve të ndërtimit pa lejen e pronarëve për të mos e prishur këtë ndërtim dhe qëndresës së familjes Toro për lirimin e truallit në pronësi të tyre, pas sugjerimit nga pala tjetër për marrëveshje, për shkak të investimit të kryer tashmë, dakordësuan që të shkëmbenin sipërfaqen e tokës truall të zënë (1,300 m<sup>2</sup>) me sipërfaqe ndërtimore në një godinë në zbatim e sipër në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë. Kjo godinë nuk po ndërtohej mbi truallin e familjes Toro për faktin që ndërmjet shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., ishte lidhur deklarata noteriale me nr. \*\*\*, datë 16.3.2013, sipas së cilës shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaronte se hiqte dorë nga investimi (godina në ndërtim e sipër në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë), kontrata për shkëmbimin e truallit në të ardhmen u lidh ndërmjet familjes Toro dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.[...].

Nga verifikimi i kontratës së shkëmbimit të lidhur mes z. I.T., etj., shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe z. K.C., në cilësinë e investitorit dhe dorëzanësit rezulton se në përmbajtje të saj janë referuar të gjitha vendimet e gjykatave të cituara si më lart, mbi bazën e të cilave është arritur marrëveshja. Objekti i kësaj kontrate është shkëmbimi në të ardhmen nëpërmjet një kontrate të dytë i sipërfaqes 1,298 m<sup>2</sup> truall, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*” Vlorë me sip. 320 m<sup>2</sup> apartamente, të cilat do të ndërtohen nga investitori, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Në nenin 2 të kësaj kontrate me titull “të drejtat dhe detyrimet e investitorit” përcaktohet se pronarët janë dakord që prona e sipërpërmendur, në përfundim të apartamenteve të përcaktuar në nenin 1, të shkëmbehet me këtë të fundit, të ndërtuara nga investitori dhe dorëzanësi dhe të transferojnë titullin

<sup>68</sup> Kontratë nr. \*\*\*kol., datë 28.7.2018.

<sup>69</sup> Pyetje/përgjigje nr. 8, pyetësori i dërguar me e-mail-in e datës 10.9.2019/përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail-in e datës 20.9.2019.

e pronësisë, ndër të tjerë, të apartamentit të z. I.T., apartament me sip. 85.7 m<sup>2</sup> plus sipërfaqen e përbashkët të porositur për djalin e tij, z. A.T.

Në vijim të shpjegimeve të saj lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, ndër të tjera, subjekti i vlerësimit, ka sqaruar se [...]për faktin se godina 7 kate, në të cilën ishin dakordësuar të merrnin sipërfaqe ndërtimore në shkëmbim të truallit, nuk ngrihej mbi truallin e familjes Toro, i vetmi instrument për të mundësuar transaksionin në favor të tyre dhe të dorëzanësit/investitorit ishte nëpërmjet dhurimit dhe u konkluduan kontratat e dhurimit mes bashkëpronarëve të familjes Toro dhe shoqërisë ndërtuese [...].

Për të provuar deklarinimet e saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka depozituar në Komision kopje të dokumenteve, si vijon: (1) vendim nr. \*\*\*, datë 27.7.1996, të KKKPishP-së; (2) vendim nr. \*\*\*, datë 28.12.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë; (3) vendim nr. \*\*\*, datë 7.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (4) kontratë nr. \*\*\* kol., datë 7.10.2013, për shkëmbim trualli në të ardhmen; si dhe (5) kontratë dhurimi nr. \*\*\* kol., datë 28.7.2018.

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara prej tij, në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni konstaton se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se [...] meqenëse sipërfaqja ndërtimore e apartamentit që do i kalonte (që i ka kaluar) bashkëshortit, z. A.T., ishte 13 m<sup>2</sup> më e madhe se ajo e bashkëpronarit tjetër z. I.T.<sup>70</sup>, u bë llogaritja e konvertimit të kësaj sipërfaqeje 13 m<sup>2</sup> në vlerën e kostos që rezultoi 3,000 euro, shumë që i përkiste xhaxhait të bashkëshortit, z. I. T. Kjo shumë, së bashku me shumën 5,000 euro për mobilimin e këtij apartamenti, në datën 21.7.2014 iu kalua bashkëshortit të subjektit në llogarinë e tij në BKT, nga babai i tij [...]. Subjekti ka depozituar, kopje të dokumentit “nxjerrje llogarie” (statement) bankare në BKT, ku konfirmohet kalimi i shumes prej 8,000 euro.

Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të dërguar nga BKT-ja<sup>71</sup> konfirmohet se në datën 21.7.2014, z. I.T., ka depozituar cash shumën prej 8,000 euro në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A.T.

Lidhur me këtë shumë të dhuruar në favor të personit të lidhur, Komisioni vlerëson se referuar pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. I.T., (babai i bashkëshortit të subjektit) bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë për kompensimin e sip. 13 m<sup>2</sup> ndërtim dhe mobilimin e banesës në Vlorë apo shumëve të tjera të dhuruara nga babai i bashkëshortit.

Por, ndërkohë, nga verifikimi deklaratës “Vetting” dhe deklarimeve periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI konstatohet se babai i bashkëshortit, z. I.T., ka kryer edhe dhurime të tjera në favor të subjektit apo personave të lidhur<sup>72</sup>: shumën 10,000 euro për blerjen e garazhit; dhe kreditime të vazhdueshme në llogaritë dyemërore që ka subjekti i rivlerësimit me fëmijët.

<sup>70</sup> Në kohën e lidhjes së kontratës së shkëmbimit të truallit para noterit.

<sup>71</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019.

<sup>72</sup> Konfirmuar si dhurime nga subjekti edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

Si rrjedhim, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. I.T., të cilat kanë krijuar shumën e dhuruar prej 8,000 euro, të shumave të tjera të dhuruara, të vetëdeklaruara nga subjekti dhe të evidentuara nga Komisioni.

Meqenëse Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për çdo shumë të dhuruar nga z. I.T., analiza financiare dhe verifikimi i ligjshmërisë së burimit të krijimit për të ardhurat e tij është kryer njëherësh për totalin e shumave të dhuruara.

Referuar deklarimeve periodike vjetore të bëra nga subjekti në ILDKPKI, babai i bashkëshortit, z. I.T., ka dhuruar shumat, si më poshtë:

Viti	Shuma e dhuruar në lekë	Shuma e dhuruar në euro	Shuma e dhuruar në dollarë	Total dhurim në lekë	Qëllimi i dhurimit
2010	0	2,000	0	277,540	Dhuratë fëmijëve
2011	0	10,000	0	1,389,300	Për blerje garazhi
2013	200,000	0	0	200,000	Dhuratë fëmijëve
2014	0	8,000	0	1,121,120	Për mobilim ap. Vlorë dhe kompensim
2015	120,000	0	0	120,000	Dhuratë fëmijëve
2016	250,000	0	0	250,000	Dhuratë fëmijëve
<b>Totali</b>	<b>570,000</b>	<b>20,000</b>	<b>0</b>	<b>3,357,960</b>	

Lidhur me burimin e të ardhurave të z. I.T., të cilat kanë shërbyer për dhurimet e mësipërme, në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>73</sup> subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...] në vitin 1992 nga Bashkia Tiranë, familjes Toro iu kthye një nga vilat më me vlerë në Tiranë (bashkëpronar i së cilës ishte edhe babai i bashkëshortit të subjektit). Që nga ky vit e në vijim, deri në shitjen e saj, familja Toro ka pasur marrëdhënie qiraje në vlerën rreth 5,000 USD/muaj. Në datën 20.12.2001 me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, familja Toro shiti pasurinë vilë +truall, të ndodhur në Rr. “\*\*\*”, në vlerën 500,000 USD, për të cilën është paguar edhe tatimi mbi kalimin e pronësisë në vlerën rreth 15,000 USD. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në datën 12.3.2009 ka ndërruar jetë halla e bashkëshortit, znj. S.T, e cila ka qenë beqare dhe pa fëmijë. Si trashëgimtar ligjor ishte edhe i ndjeri, z. I.T., në ¼ pjesë të pasurisë së saj. Sikundër pasuria e krijuar nga prona e sipërcituar, e dhënë me qira e më pas e shitur dhe halla e bashkëshortit të subjektit gëzonte pjesën e saj në këtë pasuri. Këto të ardhura dhe kursimet e saj ndër vite, i krijuan babait të bashkëshortit të subjektit edhe një kreditim tjetër të pasurisë së tij. Burim tjetër i të ardhurave të babait të bashkëshortit të subjektit janë pensionet e pleqërisë, bonot e thesarit, dëmshpërblimi si i përndjekur politik [...].

Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision kopje të dokumenteve, si vijon: (1) kontratë e qirasë së vilës, datë 1.7.1998; (2) kontratë qiraje provizore, datë 30.6.1998; (3) kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 20.11.2001; (4) vendim nr. \*\*\*, datë 12.6.2014, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të znj. S.T.; (5) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2019, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë; (6) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2019, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë; (7) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2019, i Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve; si dhe (8) nxjerrje llogarie për bono thesari nga Banka e Shqipërisë.

Referuar kontratës së qirasë së datës 1.7.1998, konstatohet se bashkëpronarët e familjes Toro, z. I. T., etj., të përfaqësuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.T., i kanë lënë me qira Ambasadës

<sup>73</sup> Pyetësori i dërguar me e-mail-in e datës 10.9.2019/përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail-in e datës 20.9.2019 (pyetje nr. 3/përgjigje nr. 3).

Italiane shtëpinë (vilën) e ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, për vlerën 5,000 USD/muaj. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është parashikuar për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar nga data 1.7.1998 deri më 30.6.2000.

Ndërsa, referuar kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të datës 20.11.2001, rezulton se bashkëpronarët e pasurisë së mësipërme (vilës në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë), pjesëtarë të familjes Toro, kanë shitur këtë pasuri për shumën prej 500,000 USD. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI duket se sipas dokumentit bankar mandatarkëtimi datë 20.12.2001, bashkëpronarët e familjes Toro kanë paguar tatimin mbi shitjen e kësaj pasurie në vlerën 15,028 USD, me përshkrimin “derdh 3 % të vlerës së shitjes me kontratë nr. \*\*\*, trashëgimtarët e familjes Toro”. Në këtë kontratë, në cilësinë e palës shitëse duket se shfaqen 9 bashkëpronarë. Nga verifikimi i dokumentacionit administruar në dosje duket se z. I.T., ka zotëruar 1/10 pjesë të kësaj pasurie.

Në vijim, Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë se sa është shuma e përfitur në total nga babai i bashkëshortit të saj nga dhënia me qira dhe shitja e vilës, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *[...]si bashkëpronarët e tjerë, babai i bashkëshortit, z. I.T., ka përfituruar 1/8 pjesë nga të ardhurat e qirasë dhe nga shitja e vilës, në vlerën rreth 120,000 USD, sikurse vetë bashkëpronarët kanë rënë dakord [...] ..Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se z. I. T., ka qenë trashëgimtar në ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore të motrës së tij, e cila ka ndërruar jetë në vitin 2009, për të cilën sqaron se ka përfituruar të njëjtat vlera monetare nga dhënia me qira dhe shitja e vilës. Në kushtet kur motra e babait të bashkëshortit ka qenë beqare, pa fëmijë, ka qenë në marrëdhënie pune e më pas gëzonte pension të plotë dhe nuk ka investuar në blerje pasurish të luajtshme apo të paluajtshme, nga vlerat e akumuluar prej saj, z. I.T., ka përfituruar një shumë prej rreth 35,000 USD [...].*

Subjekti ka depozituar në Komision si dokumentacion provues shtesë për deklaratimet e saj: (1) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019, “kthim përgjigje” të DRT-së Tiranë; (2) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019, “kthim përgjigje” të DRT-së Tiranë; si dhe (3) deklaratën noteriale nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2019.

Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në dosjen e ILDKPKI-së kontratën e qirasë së datës 1.12.1995, që i përket pasurisë së mësipërme (vilës në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë), lidhur mes z. S.T., si përfaqësues i bashkëpronarëve Toro dhe \*\*\*, sipas së cilës qiramarrësi merr në përdorim pasurinë e mësipërme për periudhën 1.12.1995 – 31.12.1996, për vlerën e qirasë mujore 4,000 USD.

Konstatohet se pas kërkesave të drejtuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në lidhje me kontratën e qirasë mes z. A.T., si qiradhënës dhe ambasadës italiane si qiramarrëse, DRT-ja Tiranë konfirmon<sup>74</sup> se për periudhën 1.7.1998 – 30.6.2000, ambasada ka kryer pagesë tatimi mbi qiranë, por pagesat janë kryer në total dhe nuk janë të specifikuar në përshkrim apo të deklaruara se cilës kontrate i përkasin. Për sa i përket marrëdhënies së qirasë me \*\*\*, DRT-ja Tiranë informon<sup>75</sup> se nga verifikimi i kryer nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar pagesat e tatimit në burim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar lidhur me pasurinë e llojit vilë dykatëshe të sipërcituar, duket se z. I.T., ka zotëruar 1/5 e ½ pjesë të kësaj pasurie dhe se tre bashkëpronarë të tjerë kanë zotëruar 1/3 e ½ pjesë të saj – të gjithë trashëgimtarë të familjes Toro.

<sup>74</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2019, nga DRT-ja Tiranë.

<sup>75</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019.

Ndërsa referuar deklaratës noteriale të datës 24.10.2019, znj. D.H., (Toro) dhe znj. N.H., (Toro) deklarojnë se në cilësinë e ish-bashkëpronarëve të pasurisë së paluajtshme të llojit vilë dykatëshe (të cilët zotëronin 1/3 e 1/2 pjesë të saj), ndodhur në Tiranë, në Rr. “\*\*\*” dhe të tjetërsuar më pas, të gjithë bashkëpronarët, si nipër e mbesa të gjyshit të tyre S.T., kanë përfituar si nga kontrata e qirasë edhe nga kontrata e shitjes raportin prej 1/8 të vlerës monetare.

Siç e evidentuam edhe më sipër, subjekti pretendon të ardhura të përfituara nga qiradhënia/shitja e vilës, në total vlerën prej 155,000 USD.

Por, në kushtet e mungesës së dokumentacionit për qiradhënien e mëparshme të vilës (para vitit 1995), si dhe nisur nga shpjegimet e subjektit se ka përfituar 1/8 e të ardhurave nga kjo pasuri, duket se vlerat e përfituara pasqyrohen në tabelën, si më poshtë:

<b>Të ardhura të përfituara nga vila, z. I. T., (llogaritur 1/8 pjesë takuese)</b>	<b>Vlera</b>
Qiradhënie Ambasadës Italiane (pag. tatimi)	15,000 USD
Shitja e vilës	60,625 USD
Qiradhënie *** Shqipëri (kont. nuk dokumentohet pagesa e tatimit)	6,500 USD
Trashëgimi ligjore 1/4 e pasurisë së motrës (të ardhurat nga vila)	20,531 USD
<b>TOTALI</b>	<b>102,656 USD</b>

Ndërsa, referuar dokumentacionit justifikues ligjor të administruar në dosje, të ardhurat e përfituara nga z. I.T., nga qiradhënia dhe shitja e vilës pasqyrohen në tabelën, si më poshtë:

<b>Të ardhura të përfituara nga vila, z. I.T., (llogaritur 1/10 pjesë takuese)</b>	<b>Vlera</b>
Qiradhënie Ambasadës Italiane (pag. tatimi)	12,000 USD
Shitja e vilës	48,497 USD
Qiradhënie IFDC/Shqipëri (kont. -nuk dok. pagesa tatimit)	5,200 USD
Trashëgimi ligjore 1/4 e pasurisë së motrës (të ardhurat nga vila)	16,424 USD
<b>TOTALI</b>	<b>82,121 USD</b>

Por, është fakt se referuar të dhënave nga BKT-ja rezulton se në llogarinë e përbashkët me nr. \*\*\*, në dollarë, të shtetasve I., dhe M.T., (prindërit e bashkëshortit të subjektit), në datën 20.9.2002 kanë qenë të depozituara në depozitë me afat shumëmat 41,000.48 USD dhe 80,429.02 USD.

Gjithashtu, konstatohet se z. I.T., babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ka përfituar pension pleqërie<sup>76</sup>, që nga korriku i vitit 1990, në masën aktuale 26,895 lekë/muaj.

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara në Komision në kuadër hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se z. I.T., ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumëmat e dhuruara ndër vite, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

**28. Pasuria e llojit vendparkim (garazh)<sup>77</sup>, me vlerë 12,000 euro.** Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar shumëmat prej 10,000 euro, si kontribut i babait të bashkëshortit dhënë pa

<sup>76</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2017, e ISSH-së.

<sup>77</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*dhe aneks \*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së): (1) certifikatë pronësie nr. \*\*\*, lëshuar në datën 1.10.2012 për garazhin me sip. 17 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*; dhe (2) lidhur me të ardhurat dhe kontributin financiar të dhënë, z. I.T., ka depozituar dokumentacionin, si vijon: (i) vërtetim pronësie i vitit 1991 sipas të cilit konfirmohet se prona e ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, figuron e regjistruar në datën 28.12.1970, në favor të shtetit kundër z. S.T.; (ii) vërtetim pronësie datë 10.11.1995 për truallin e parë me sip. 337 m<sup>2</sup> dhe truallin e dytë me sip. 143 m<sup>2</sup>, pronë e cila është regjistruar me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.8.1995, të KKKP-së dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 3.7.1998; (iv) kontratë qiraje lidhur në datën 1.12.1995; (v) prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 30.9.1998; (vi) kontratë qiraje lidhur në datën 30.6.1998; (vii) kontratë qiraje lidhur në datën 1.7.2000; (viii) kontratë shitblerjeje pasurie datë 20.12.2001.

dokument për shkak të lidhjes së posaçme dhe shumën prej 2,000 euro nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit.

Referuar DPV-së së vitit 2011, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar blerje vendparkimi në vlerën 12,000 euro dhe se 10,000 euro për blerjen e tij janë dhënë nga babai i bashkëshortit, në dy pjesë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar vlerën prej 2,000 euro si detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*”, për blerjen e vendparkimit të mësipërm.

Ndërsa në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar të shlyer detyrimin në vlerën prej 1,900 euro (mandat nr. \*\*\*, datë 20.7.2012) ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe se nuk ka më detyrim ndaj kësaj shoqërie.

### Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

**ZVRPP-ja Tiranë**<sup>78</sup> konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimi, znj. Elona Toro, është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuria e llojit garazh me sip. 17 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

Nëpërmjet kontratës<sup>79</sup> së datës 18.9.2012, subjekti i rivlerësimi dhe bashkëshorti kanë blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit garazh me sipërfaqe të shfrytëzueshme prej 17 m<sup>2</sup>, në katin e dytë të godinës së ndërtuar nga kjo shoqëri, të ndodhur në “\*\*\*\*” Tiranë, për çmimin 12,000 euro. Referuar kësaj kontrate, pagesa është kryer nga shitësi te blerësi jashtë zyrës noteriale.

Duket se të drejtat reale mbi këtë pasuri janë fituar nga subjekti që në vitin 2011, sipas vetëdeklarimit të bërë në ILDKPKI, por me dorëzimin e deklaratës “Vetting” nuk ka depozituar në ILDKPKI dokumentacion mbi prenotimin e kësaj pasurie në vitin 2011, si dhe në dosjen e ardhur nga ZVRPP-ja nuk disponohet dokumentacion për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie në po këtë vit. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, subjekti depozitoi kontratën e lidhur në datën 11.5.2011 me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për prenotimin e kësaj pasurie<sup>80</sup>.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti i rivlerësimi ka deklaruar se çmimi për blerjen e garazhit është paguar me këste pasqyruar në tabelën, si më poshtë:

Datë	Shuma në euro	Forma e pagesës
11.5.2011	1,100	Transfertë BKT në llogarinë në ISP të shoqërisë
11.5.2011	3,000	Depozituar <i>cash</i> në llogarinë bankare të shoqërisë
23.5.2011	1,000	<i>Cash</i> pranë financës së shoq. ndërtuese, mandatarkëtimi nr. ***
11.11.2011	5,000	<i>Cash</i> pranë financës së shoq. ndërtuese, mandatarkëtimi nr. ***
20.7.2012	1,900	<i>Cash</i> pranë financës së shoq. ndërtuese, mandatarkëtimi nr. ***

Pra, rezulton se për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011 subjekti ka paguar shumën prej 10,100 euro dhe në vitin 2012, shumën prej 1,900 euro.

Referuar deklarimit të subjektit për planin e pagesave të kryera në favor të shoqërisë ndërtuese për blerjen e garazhit evidentohet pasaktësi në DPV-në 2011, pasi është deklaruar si shumë e mbetur detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese, vlera prej 2,000 euro.

Në shpjegimet e dhëna me dërgimin e prapësimeve, subjekti pranon faktin e deklarimit në mënyrë të pasaktë të detyrimit ndaj shoqërisë, duke shënuar vlerën 2,000 euro në vend të vlerës 1,900 dhe sqaron

<sup>78</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2019.

<sup>79</sup> Kontratë nr. \*\*\*, datë 18.9.2012.

<sup>80</sup> Depozituar në Komision me pyetësorin nr. 6, dërguar me e-mail-in e datës 10.12.2019.

se ky gabim në deklaram ka ardhur si rrjedhojë e rrumbullakosjes së vlerës së detyrimit dhe se nuk ka pasur asnjë qëllim tjetër.

Komisioni vlerëson se duken bindëse shpjegimet e subjektit dhe se kjo pasaktësi në deklaram ka një peshë specifike shumë të vogël, pasi është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk do të merret në konsideratë gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar.

Siç u evidentua më sipër, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. I.T., ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar shumat e dhuruara ndër vite për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara në Komision, në kuadër hetimit administrativ konstatohet se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri.

Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime për vitin 2012, nga ku rezultoi se ky vit, gjatë të cilit është kryer edhe pagesa e këstit të fundit për garazhin, paraqitet me balancë negative fondesh në shumën prej 341,577 lekësh.

Sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare për të justifikuar plotësisht shtesën e pasurive (likuiditetet e shtuara në llogari bankare) apo shpenzimet e kryera për vitin 2012, ku përfshihet edhe pagesa e kryer për blerjen e garazhit, në vlerën 1,900 euro.

Në shpjegimet e saj, lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit pretendon reduktimin e shpenzimeve jetike, kryesisht sa i takon shpenzimeve për fëmijët, pasi deklaron se për atë vit i ka pasur në kopsht shtetëror me pagesë minimale prej 3,600 lekësh/muaj, ku përfshihej mëngjesi dhe dreka, si dhe gjatë muajve të verës, kryesisht, fëmijët kanë qëndruar te gjyshërit (prindërit e bashkëshortit), të cilët kanë mbuluar të gjitha shpenzimet e tyre.

Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit lidhur me reduktimin e shpenzimeve në analizën financiare të vitit 2012 mbeten të karakterit deklarativ, të pabazuara në prova dhe, si rrjedhojë, ky vit mbetet me balancë negative fondesh.

Gjithsesi, Komisioni e ka të vështirë të përcaktojë nëse kjo balancë negative ndikon shpenzimet e kryera apo pasuritë e krijuara, shtesat e likuiditeteve në bankë apo pagesën e kryer për blerjen e garazhit.

Vlen të theksohet se referuar analizës financiare të gjitha, vitet paraardhëse paraqiten me balanca pozitive fondesh në vlera të konsiderueshme. Gjithashtu, evidentohet fakti se në DPV-në e vitit 2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura *neto* (fitimi *neto*) shumën prej 1,937,270 lekësh, të përfituara nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit si avokat, por ndërkohë në analizën financiare të kryer nga Komisioni, të ardhurat *neto* (fitimi) nga aktiviteti i bashkëshortit janë pasqyruar në shumën prej 465,367 lekësh sipas të dhënave të konfirmuara nga organet tatimore – fakt ky i pakundërshtuar nga subjekti. Thënë këto, ky vit financiar me balancë negative mund të ketë ardhur edhe si pasojë e deklaramit të pasaktë të likuiditeteve *cash* nga subjekti dhe personit të lidhur me të apo edhe e mosdokumentimit të plotë të të ardhurave të përfituara nga aktiviteti si avokat i bashkëshortit të subjektit.

Gjithsesi, si konkluzion Komisioni vlerëson se balanca negative e fondeve për vitin 2012, për një total të akumuluar në shumën prej 341,577 lekësh, nuk është e mjaftueshme që të sjellë aplikimin e



pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës edhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**29. Pasuria e llojit automjet, tip “Mercedes Benz \*\*\* CDI”<sup>81</sup>, me targa AA \*\*\***, 100 % në pronësi me bashkëshortin, përfituar me kontratë shkëmbimi të datës 10.12.2014. Subjekti ka deklaruar se e ka përfituar këtë pasuri duke e shkëmbyer me automjetin tip “Volkswagen Bora” të cilin e kishte blerë më parë në vlerën prej 4,500 euro.

Referuar DPV-së së vitit 2014 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e shkëmbimit nr. \*\*\*, datë 10.12.2014, të automjetit tip “Volkswagen Bora” me automjetin tip “Mercedes Benz \*\*\*”, vit prodhimi 2004, me targa AA \*\*\*.

DPSHTRr-ja<sup>82</sup> informon se në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. A.T., është i regjistruar automjeti me targa AA \*\*\*, duke na dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti.

Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti konfirmohet se nëpërmjet kontratës noteriale të datës 10.12.2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shkëmbyer automjetin tip “Volkswagen Bora” me targa AA \*\*\*, me automjetin tip “Mercedes Benz \*\*\* CDI”.

Referuar DPV-së së vitit 2013 konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Volkswagen Bora”, me targa AA \*\*\*, vit prodhimi 2003, me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, për vlerën 4,500 euro.

Meqenëse automjeti tip “Mercedes Benz” është fituar si rezultat i shkëmbimit me automjetin tip “Volkswagen Bora”, Komisioni i kërkoi<sup>83</sup> subjektit të deklarojë se cili është burimi i krijimit të këtij automjeti, blerë në vitin 2013 për shumën 4,500 euro.

Me përgjigjet e dërguara në Komision,<sup>84</sup> subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera deklaroi se [...] *burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Bora” është: (i) shitja me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.7.2013 e automjetit me targa TR \*\*\*, për çmimin 3,000 euro; dhe (ii) shumën prej 1,500 euro nga kursimet e tyre, të cilat i janë dhënë cash përfaqësuesit me prokurë të posaçme nr. \*\*\*, datë 2.7.2013, për të kryer të gjitha procedurat përkatëse që nga blerja, transporti, zhdoganimi, targat, nxjerrja e lejes së qarkullimit e deri në regjistrimin e automjetit në pronësi të bashkëshortit të saj [...].*

Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision kopje të dokumenteve, si vijon: (1) prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 2.7.2013; (2) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 8.7.2013; (3) deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.9.2019; (4) dokumentet e zhdoganimit e deri në regjistrimin e automjetit me targa AA \*\*\*; si dhe (5) certifikatë e pronësisë së automjetit me targa AA \*\*\*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konfirmohet se nëpërmjet kontratës së shitjes së datës 8.7.2013, z. A.T., (personi i lidhur) ka shitur automjetin e tipit “Mercedes Benz”, me targa TR \*\*\*, për vlerën 3,000 euro.

---

<sup>81</sup>Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së): (1) kontratë shkëmbimi pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 10.12.2014; (2) deklaratë doganore nr. \*\*\*, datë 18.10.2014; (3) dokument, printuar nga sistemi i DPSHTRr-së për kartelën e automjetit tip “Volkswagen Bora”, me targa AA \*\*\*dhe AA \*\*\*; (4) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 8.7.2013; dhe (5) kopje nga sistemi elektronik i DPSHTRr-së lidhur me të dhënat e automjeteve me targa AA \*\*\* dhe AA \*\*\*.

<sup>82</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019, nga DPSHTRr-ja.

<sup>83</sup> Pyetësori nr. 2, dërguar me e-mail-in e datës 10.10.2019.

<sup>84</sup> Përgjigjet e dërguara në Komision me e-mail-in e datës 20.10.2019 (pyetja nr. 9/përgjigjja nr. 9).

Referuar deklaratës fillestare të pasurisë (dorëzuar në ILDKPKI, në datën 23.3.2004) konstatohet se subjekti ka deklaruar automjetin tip “Mercedes Benz 190 (\*\*\*)”, me targa TR \*\*\*, për vlerën 600,000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshortin dhe me burim krijimi kursimet e familjes.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni konstatohet se për periudhën para fillimit të detyrës (kur është blerë automjeti tip “Mercedes Benz” me targa TR \*\*\*<sup>85</sup>) dhe viti 2013 (kur është paguar nga kursimet shuma prej 1,500 euro<sup>86</sup>) rezultojnë me balancë pozitive të fondeve.

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, vetëdeklarimeve të subjektit dhe provave të depozituara prej saj në Komision, në kuadër të hetimit administrativ konstatohet se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

**30. Dy pasuri të llojit apartament<sup>87</sup>, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”:** (1) pasuria me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*; dhe (2) pasuria me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ku personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) zotëron ¼ pjesë, në vlerën prej 40,960 lekësh.

Si burim krijimi personi i lidhur ka deklaruar: përfitur nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Nga verifikimi i deklaratave periodike të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI konstatohet se personi i lidhur nuk ka deklaruar më parë të drejtat reale/pjesën takuese mbi këto pasuri, por Komisioni vlerëson se për sa kohë kjo pasuri është fituar me ligj dhe nuk ka dyshime për krijimin e saj, kjo pasaktësi në deklaram është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk do të merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar.

ZVRPP-ja Tiranë<sup>88</sup>, ndër të tjera, informon se nga verifikimi digjital dhe nga dokumentacioni që zotëron rezulton se z. A.T., (bashkëshorti i subjektit) ka të regjistruar (pasuri aktuale) në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurinë e llojit apartament me sip. 105.6 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\* dhe se zotëron ¼ pjesë të kësaj pasurie. Kjo pasuri është regjistruar në datën 21.11.2018 dhe është krijuar nga bashkimi i dy pasurive: (i) pasuria e llojit apartament me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*; dhe (ii) pasuria e llojit apartament me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se fillimisht dy pasuritë e llojit apartament janë përfitur në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Sipas kontratës së shitblerjes së datës 9.8.1993, rezulton se z. I.T., znj. M.T., z. A. T., dhe znj. E.T., (pjesë përbërëse e të njëjtës certifikatë familjare) kanë blerë nga Ndërmarrje Komunale Banesa Nr. 3, dy pasuri të llojit apartament, të ndodhura në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, përkatësisht p. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, dhe ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, secili me sip. 52.8 m<sup>2</sup>, në total për vlerën prej 40,960 lekësh.

Neni 9 i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” përcakton se: *“...banesat që do të privatizohen do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe të anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij”*. Si rrjedhim, dy pasuritë e përfituara nëpërmjet këtij ligji, të blera nga

<sup>85</sup> Shitja e këtij automjeti ka shërbyer si burim krijimi për automjetin tip “Volkswagen Bora” nga shkëmbimi i të cilit është fituar pasuria objekt hetimi.

<sup>86</sup> Shumë e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Bora” nga shkëmbimi i të cilit është fituar pasuria objekt hetimi.

<sup>87</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së): (1) certifikatë për vërtetimin e pronësisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 30.3.2012; dhe (2) certifikatë për vërtetimin e pronësisë nr. \*\*\*, lëshuar në datën 18.2.2012.

<sup>88</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2019.

Ndërmarrje Komunale Banesa Nr. 3 Tiranë, janë regjistruar në emër të katër bashkëpronarëve, pjesëtarë të familjes Toro.

Bazuar në kërkesën e bërë nga bashkëpronarët (që mban datën 6.11.2018), ZVRPP-ja Tiranë ka bërë bashkimin e këtyre dy pasurive në një të vetme dhe pas transaksionit të gjeneruar nga bashkimi i tyre ka regjistruar pasurinë e llojit apartament banimi me sip. 105.6 m<sup>2</sup>, ku secili bashkëpronar zotëron ¼ pjesë takuese të saj.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se përputhet deklarimi i subjektit/personit të lidhur me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë për gjendjen e këtyre pasurive/kësaj pasurie në momentin e deklarimit dhe se nuk ka dyshime për zotërimin e ¼ pjesë takuese nga personi i lidhur mbi këto/këtë pasuri.

### **Deklarimi i llogarive bankare**

**31. Gjendje depozitë në euro<sup>89</sup>**, llogari në BKT sh.a., në emër të subjektit të rivlerësimit, shuma prej 1,105.18 euro.

Referuar të dhënave nga BKT-ja, kjo shumë përbëhet nga dy depozita të hapura në vitin 2016, me vlera përkatësisht 605 euro dhe 500.16 euro (në datën 31.12.2016).

**32. Gjendje depozitë në lekë**, llogari në BKT sh.a., në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të vajzës së saj E. T., në vlerën 2,536,585.17 lekë<sup>90</sup>.

Referuar të dhënave nga BKT-ja, kjo depozitë është hapur në tetor të vitit 2002 dhe përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga banka për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

Përgjatë gjithë kësaj periudhe, kjo llogari, përveçse nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, është kredituar në vazhdimësi edhe me shuma të dhuruara nga babai i saj dhe i bashkëshortit. Shtesat e kësaj llogarie (nëpërmjet dhurimeve *cash* apo kreditimit direkt në llogari) të kryera nga babai i subjektit dhe babai i bashkëshortit të saj janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore si dhurime.

Analiza e burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur për këto vlera të dhuruara është kryer me trajtimin e pasurisë së llojit apartament, të blerë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin.

**33. Gjendje depozitë në lekë, llogari në BKT sh.a.**, në emër të shtetasve E., dhe Elona Toro, në vlerën 1,354,506.99 lekë<sup>91</sup>.

Referuar të dhënave nga BKT-ja, kjo depozitë është hapur në vitin 2007 dhe përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga banka për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

---

<sup>89</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga BKT-ja.

<sup>90</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): vërtetimin e datës 24.1.2017, lëshuar nga BKT-ja dhe nxjerrje llogarie nga kjo bankë.

<sup>91</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): vërtetimin e datës 24.1.2017, lëshuar nga BKT-ja dhe nxjerrje llogarie nga kjo bankë.

Përgjatë gjithë kësaj periudhe, kjo llogari, përveçse nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, është kredituar në vazhdimësi edhe me shuma të dhuruara nga babai i saj dhe i bashkëshortit. Shtesat e kësaj llogarie (nëpërmjet dhurimeve *cash* apo kreditimit direkt në llogari) të kryera nga babai i subjektit dhe babai i bashkëshortit janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore si dhurime.

Analiza e burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur, për këto vlera të dhuruara, është kryer me trajtimin e pasurisë së llojit apartament, të blerë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin.

**34. Gjendje në llogarinë e pagës në lekë në “Credins Bank” sh.a.,** në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 216,069.08 lekë<sup>92</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Credins<sup>93</sup> Bank” konfirmohet se kjo llogari është hapur në vitin 2010 dhe është llogaria ku kreditohet paga e subjektit të rivlerësimit.

Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga kjo bankë për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**35. Gjendje llogarie në lekë në BKT sh.a.,** (llogari e kredisë) në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 144,004.36 lekë<sup>94</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga BKT-ja rezulton se kjo llogari është hapur në vitin 2011 dhe ka shërbyer për likuidimin e kësteve të kredisë së butë.

Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga kjo bankë për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**36. Gjendje llogarie në euro, në BKT sh.a.,** në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A.T., (Person Fizik), në vlerën 2,324.38 euro<sup>95</sup>.

Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja rezulton se kjo llogari është hapur në vitin 2012 dhe se është përdorur nga bashkëshorti i subjektit për aktivitetin e tij të regjistruar. Konstatohet se deklarimi i subjektit/personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga banka për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**37. Gjendje llogarie në lekë, në BKT sh.a.,** në emër të bashkëshortit, z. A.T., (Person Fizik), në vlerën 684,369.8 lekë<sup>96</sup>.

Referuar të dhënave të dërguara nga BKT-ja rezulton se kjo llogari është përdorur nga bashkëshorti i subjektit për aktivitetin e tij të regjistruar. Konstatohet se deklarimi i subjektit/personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga banka për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

---

<sup>92</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së):nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 23.1.2017.

<sup>93</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019/ protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2019.

<sup>94</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së):nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 23.1.2017.

<sup>95</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 23.1.2017.

<sup>96</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 23.1.2017.

**38. Gjendje llogarie në lekë në BKT sh.a.,** në emër të bashkëshortit, z. A.T., në vlerën 114,761.24 lekë<sup>97</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga BKT-ja konstatohet se kjo është një llogari rrjedhëse e krijuar në vitin 2004, e cila duket se ka shërbyer kryesisht si llogari page për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Për periudhën 2011 – 2016 rezultojnë debitime/kreditime për aktivitetin e biznesit të regjistruar, përfshirë këtu edhe kalime vlerash monetare me përshkrim “pagë nga llogaria e biznesit”.

Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit/personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga banka për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**39. Gjendje llogarie në euro** në “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, në vlerën 2,768.81 euro<sup>98</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>99</sup> rezulton se kjo llogari është hapur në vitin 2011. Konstatohet se deklarimi i subjektit/personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga kjo bankë për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**40. Gjendje llogarie në lekë në “Union Bank” sh.a.,** në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A. T., në vlerën 208,637 lekë<sup>100</sup>.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga “Union Bank”<sup>101</sup> rezulton se kjo llogari është hapur në vitin 2014 dhe se në këtë llogari janë transferuar të ardhura nga aktiviteti i regjistruar i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Konstatohet se deklarimi i subjektit/personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga kjo bankë për gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**41. Gjendje llogarie në lekë në BKT sh.a.,** në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 174,489.98 lekë<sup>102</sup>.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti lidhur me këtë pasuri, si dhe në dokumentacionin bankar të administruar nga banka, në kuadër të hetimit administrativ duket se subjekti ka deklaruar dy herë të dhëna lidhur me gjendjen e llogarisë së kredisë në BKT (llogaria nr. \*\*\*). Kjo llogari është trajtuar në pikën 10 të këtij relacioni, ku subjekti ka deklaruar saktësisht gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës në shumën prej 144,004 lekësh. Ndërkohë, duket se këtë herë subjekti ka deklaruar gjendjen e kësaj llogarie në datën 31.12.2016, konfirmuar edhe nga verifikimi i kësaj llogarie trajtuar, si më sipër.

**42. Gjendje llogarie në lekë (llogari kursimi) në BKT sh.a.,** në emër të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1,501.94 lekë<sup>103</sup> dhe referuar të dhënave nga banka, kjo llogari është hapur në vitin 2016.

<sup>97</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 23.1.2017.

<sup>98</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 23.1.2017.

<sup>99</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 7.2.2019/ protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2019.

<sup>100</sup>Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\*në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga “Union Bank”, datë 23.1.2017.

<sup>101</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019/protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019.

<sup>102</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 23.1.2017.

<sup>103</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 24.1.2017.

## **Konkluzione lidhur me llogaritë bankare**

Nga analizimi në tërësi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, si dhe referuar vetëdeklarimeve (ndër vite dhe në deklaratën “Vetting”) lidhur me këtë llogari konstatohet se deklarimi i subjektit përputhet me deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, në momentin e deklarimit.

Por, konstatohet se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre dhe për disa llogari nuk ka deklaruar apo nuk ka deklaruar saktë shtesat/pakësimet apo gjendjet e tyre në fund të çdo viti.

Në shpjegimet e sjella, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit pranon pasaktësitë në deklarimet, ndër vite, por ka sqaruar se në asnjë rast qëllimi nuk ka qenë fshehja e pasurisë, për më tepër kur të dhënat për këto llogari ndodheshin të evidentuara në institucionet bankare. Për të mbështetur deklarimet, subjekti ka depozituar si provë të re edhe një shkresë sqaruese<sup>104</sup> drejtuar ILDKPKI-së, me anë të së cilës saktëson deklarimin për llogarinë në euro në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në kohë të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme, në deklaratat periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI, ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre llogarive dhe se këto deklarime nuk cenojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, i cili është nga të ardhurat nga pagat, kontributi i përbashkët familjar dhe dhurimet e prindërve saj dhe të bashkëshortit.

Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson se verifikimi i këtyre llogarive bankare merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të pikave 2 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, duke verifikuar saktësinë e deklarimit të tyre me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting” dhe për të provuar burimin e ligjshëm të këtyre pasurive në formë likuiditetesh gjendje në llogari bankare.

Sikurse u evidentua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar saktë të dhënat lidhur me llogaritë bankare dhe gjendjen e tyre në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”. Gjithashtu, në referim të analizës financiare të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe të analizës financiare të kryer për personat e tjerë të lidhur ka rezultuar se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e këtyre llogarive; dhe (ii) personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht krijimin e shumave të dhuruara me anë të të cilave janë kredituar në vazhdimësi llogaritë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe të fëmijëve të saj.

Për sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se gjendjet e likuiditeteve në llogaritë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë krijuar nga burime financiare të ligjshme.

## **Pasuri në përdorim nga subjekti i rivlerësimit**

43. Subjekti ka deklaruar përdorimin e automjetit tip “Mercedes Benz \*\*\* CDI”<sup>105</sup>, me targa AA \*\*\*, sipas kontratës së përdorimit të automjetit nr. \*\*\*, datë 6.8.2013, pasuri në pronësi të babait të bashkëshortit, z. I.T. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat

<sup>104</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2013, e protokolluar në ILDKPKI.

<sup>105</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* dhe aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): (1) kontratë huapërdorje nr. \*\*\*, datë 6.8.2013; (2) kopje nga sistemi elektronik i DPSHTRr-së për të dhënat e automjetit me targa AA \*\*\*; dhe (3) dokumentacion për të ardhurat e babait të bashkëshortit të saj që kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie (aneks \*\*\*).

nga qiradhëniet e pasurisë së paluajtshme, nga shuma e trashëguar prej motrës së tij dhe nga shitja përfundimtare e vilës në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, shuma këto të përfituara nga babai i bashkëshortit të subjektit.

Referuar kontratës së huapërdorjes datë 6.8.2013 konstatohet se z. I.T., (babai i bashkëshortit të subjektit) në cilësinë e pronarit të automjetit tip “Mercedes Benz \*\*\* CDI” u jep në huapërdorje këtë automjet shtetasve A., dhe Elona Toro për një kohë të pacaktuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

DPSHTRr-ja<sup>106</sup> informon se shtetasi I.T., ka të regjistruar automjetin me targa AA \*\*\*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ky institucion konstatohet se z. I.T., në datën 16.7.2013 e ka porositur automjetin në shtetin italian për vlerën 11,000 euro dhe pas kryerjes së procedurave të zhdoganimit dhe pagesës së detyrimeve doganore në shumën prej 409,338 lekësh, ky automjet është regjistruar në emër të tij.

E pyetur nga Komisioni nëse ka përdorur pasuri të regjistruara në emër të dikujt tjetër, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>107</sup>[...] *bashkë me bashkëshortin ka përdorur pasurinë e llojit automjet, të tipit “Mercedes Benz”, me targa AA \*\*\*, të deklaruar edhe në formularët e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesave, si dhe në formularin e vetëdeklarimit [...].*

Në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pikat 11 dhe 19 të nenit 3 dhe nenin 32, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 4, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri në përdorim në deklaratën “Vetting”, si dhe ka paraqitur dokumentacionin justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të saj.

Lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, nga analiza e të ardhurave të krijuara, ndër vite, nga personi tjetër i lidhur, Komisioni konstaton se z. I.T., ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka dyshime për ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie nga personi tjetër i lidhur, z. I.T.

### **Deklarime të tjera pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”**

44. Referuar DPV-së së vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë<sup>108</sup> sipërmarrje me shoqërinë ” \*\*\*\*”, për blerjen e një apartamenti me sip. 72.17 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*\*. Vlera e objektit është 102,125 euro (objekt i papërfunduar). Nga vlera totale e kontratës është likuiduar shuma 65,000 euro (nga të cilat 10,000 euro të ardhura nga puna dhe kursime derdhur nëpërmjet bankës dhe 55,000 euro kredi bankare në BKT).

Të ardhurat e deklaruara për këtë vit janë nga puna si gjyqtare në vlerën 1.396.315 lekë dhe nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat në vlerën 3.600,763 lekë, ndërkohë që deklaroi shlyerje kredie (për të dyja kreditë 365.827 lekë + 54.700 lekë), si dhe shpenzime për pushime në Slloveni, Salzburg në vlerën 5,500 euro.

<sup>106</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019.

<sup>107</sup> Pyetësori nr. 1 dërguar me e-mail-in e datës 30.1.2019/ përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail-in e datës 23.1.2019 (pyetja nr. 6/ përgjigjja nr. 6).

<sup>108</sup> Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\* kol., datë 11.7.2017.

## Analiza e burimeve për kryerjen e pagesave për prenotimin e kësaj pasurie

### i. Shuma prej 10,000 euro të ardhura nga puna dhe kursime derdhur nëpërmjet bankës:

Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank” nga llogaria e përbashkët në euro nr. \*\*\*, në datën 13.7.2017 është transferuar shuma prej 10,000 euro në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*”, me përshkrimin “pagesë kësti i parë për blerje apartamenti”.

Lëvizjet e llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank”: (i) gjendja e likuiditeteve në këtë bankë në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 2,768.81 euro; (ii) kreditime nga likuidimet për periudhën 1.1.2017 – 20.6.2017 (të shërbimeve si avokat të faturuara) në vlerën 9,280 euro; (iii) tërheqje nga llogaria në datën 5.1.2017, në vlerën 2,000 euro; (iv) gjendje në datën 13.7.2017, në vlerën 10.046.53 euro (nga e cila në të njëjtën datë është transferuar vlera prej 10,000 euro në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*”).

### ii. Kredia bankare në BKT

Referuar të dhënave nga BKT-ja rezulton se në datën 2.10.2017 është lidhur kontrata e kredisë bankare hipotekore, midis kësaj banke (në cilësinë e kredihënësit) dhe z. A.T., (në cilësinë e kredimarrësit). Në objektin e kësaj kredie është përcaktuar si total kreditimi shuma prej 7,300,000 lekësh për blerje banese. Në aneksin e elementeve specifike të kredisë, përcaktohet se shuma prej 7,300,000 lekësh do të transferohet nga llogaria e kredisë në llogarinë e shitësit të objektit të kredituar, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

Në datën 2.11.2017 është *disbursuar* kredia në vlerën 7.300.000 lekë, në llogarinë nr. \*\*\* në ALL në BKT, në emër të z. A.T., dhe në datën 3.11.2017 është transferuar shuma prej 7.342.500 lekësh në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “kësti i dytë për blerje apartamenti”.

### iii. Pagesa të kryera gjatë vitit 2018

Në datën 19.6.2018 është transferuar shuma prej 20.000 euro nga llogaria e përbashkët në euro në nr. \*\*\*, në “Intesa Sanpaolo Bank” në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “përmbushje detyrimi kontrate kësti i tretë i kontratës së sipërmarrjes”. Kjo shumë ka ardhur si rezultat i kreditimeve nga pagesat për shërbime juridike duke iu shtuar gjendjes së mbartur nga viti 2017 (shumës 11,595.25 euro, gjendje në datën 1.1.2018).

Referuar të dhënave nga BKT-ja rezulton se në datën 12.12.2018 është transferuar nga llogaria në euro nr. \*\*\* e z. A.T., shuma prej 17,125 euro, në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*”, me përshkrimin “pagesë kësti 4 dhe 5 sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 11.7.2017”.

Gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2017 në llogarinë e biznesit ka qenë në vlerën 7,664.38 euro. Në këtë llogari janë kredituar pagesat për shërbime juridike në vlerën 19,270 euro. Në datën 11.12.2018 gjendja në këtë llogari ka qenë në vlerën 19,305.88 euro. Në datën 12.12.2018 është transferuar në llogarinë në euro nr. \*\*\*, në BKT, shuma prej 17,175 euro, në emër të z. A.T., nga llogaria e aktivitetit si Person Fizik.

DRT-ja Tiranë<sup>109</sup> informon se për vitet 2017 dhe 2018 subjekti “\*\*\*\*” Person Fizik, ka realizuar qarkullim dhe fitim pas tatimit vlerat e pasqyruara në tabelën, si më poshtë:

Viti	Qarkullimi (lekë)	Fitimi pas tatimit (lekë)
2017	3,600,763	2,231,055
2018	4,022,862	2,654,181

<sup>109</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2019.



<b>Totali</b>	<b>7,623,625</b>	<b>4,885,236</b>
---------------	------------------	------------------

Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe vetëdeklarimeve të subjektit, Komisioni konstaton se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se nuk ka dyshime për krijimin e saj.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vlerë relativisht të vogël, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

45. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>110</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat

<sup>110</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Elona Toro<sup>111</sup>.

Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe të integritetit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

### **Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>112</sup>**

46. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Referuar raportit konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara<sup>113</sup> është konstatuar se identifikon qartë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Elona Toro ka aftësi të mira procedurale dhe në organizimin e punës.

<sup>111</sup>Raporti për kontrollin e figurës është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.12.2019, të KDZH-së.

<sup>112</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019.

<sup>113</sup> Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në raportin e plotë të mbajtur nga KLGJ-ja (raporti nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit znj. Elona Toro”), me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

Vërehet se ndër pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se në tri raste është tejkalimi i afatit standard të gjykimit i vendosur nga KLD-ja, ku në një rast kohëzgjatja e gjykimit ka ardhur për shkaqe të justifikuar. Por, meqenëse në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin sasior<sup>114</sup>, si dhe vërehet se kjo gjyqtare bën përpjekje për përfundimin në kohë të gjykimeve, duket se është e justifikuar problematika lidhur me tejkalimin e afateve të gjykimit për këto raste. Gjithsesi, nga vlerësimi në tërësi i rrethanave të mësipërme duket se subjekti i rivlerësimit është *eficient* dhe efektiv në masë të pranueshme në drejtim të kohës së gjykimit duke treguar aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

Në vlerësim të respektimit të disiplinës në punë vërehet se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur me besnikëri dhe disiplinë të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të saj dhe se komunikimi në cilësinë e gjyqtares është korrekt dhe ligjor. Gjyqtarja Elona Toro tregon aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Subjekti i rivlerësimit, në vazhdimësi, ka shprehur gatishmëri për t'u rritur profesionalisht, duke kryer trajnime në Shkollën e Magjistraturës dhe tej programit të saj, si dhe jashtë vendit.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se, përgjithësisht, aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Gjatë gjykimit, gjyqtarja Elona Toro, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe zhvillon siç duhet procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve, prezantimin e gjykatës, debatin dhe hetimin gjyqësor, pohimet e palëve, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në shpalljen e vendimit. Nga pikëpamja formale, vendimet përfundimtare të hartuara prej saj, plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal apo kërkesat e legjislacionit procedural civil janë të qarta dhe të kuptueshme.

Megjithatë, nga analizimi në tërësi i raportit të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për veprimtarinë e gjyqtares Elona Toro konstatohen disa problematika të evidentuara kryesisht nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, si vijon:

i. Në një rast është vërejtur se ndërsa në pjesën arsyetuese të vendimit konkludohet për një masë konkrete dëmshpërblimi, vlera nuk reflektohet në dispozitivin e vendimit. Ky fakt është konstatuar edhe gjatë kontrollit gjyqësor të kësaj çështjeje (shih dosjen nr. \*\*\*). Në këtë rast, vërehet se vendimi i gjyqtares Elona Toro është prishur dhe është kthyer për rigjykim për mungesë hetimi të plotë e të gjithanshëm, për mosdisponimin në dispozitiv të vlerës konkrete të dëmshpërblimit.

ii. Në një rast tjetër, ndërsa është arsyetuar në detaje mbi vlerësimin se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të pajustificuar, në shkelje të procedurës dhe afatit të njoftimit, nuk është arsyetuar rreth shkaqeve për caktimin e masës së dëmshpërblimit nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës (shih dosjen nr. \*\*\*);

iii. Në katër nga pesë dosjet e vëzhguara mungon vendimi për caktimin e seancës përgatitore (shih dosjet nr. 1,2, 3 dhe 4) dhe në një rast mungon vendimi për caktimin e seancës gjyqësore (shih dosjen nr. \*\*\*). Në rastin e dosjes nr. \*\*\* mungon gjithashtu akti për caktimin e gjyqtares për gjykimin e çështjes, si dhe akti i njoftimit të palëve, mangësi e cila nuk ka sjellë pasoja në gjykim, pasi palët kanë qenë të pranishme dhe seanca është zhvilluar normalisht, madje vendimi është miratuar edhe nga gjykata më e lartë gjatë kontrollit gjyqësor të tij. Gjithsesi, këto problematika të konstatuara duket

---

<sup>114</sup> Përafërsisht 2- fish.

se nuk përmbushin kushtet e përcaktuara për nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë se gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Elona Toro janë paraqitur gjithsej 9 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (3 në vitin 2013, 2 ankesa në vitin 2014, 3 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016), nga të cilat:

- 4 ankesa (1 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat, një ankesë me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë dhe tri me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.
- 5 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë, si më poshtë:
  - 2 ankesa të vitit 2013 nga të cilat: (i) një ankesë e verifikuar për zvarritje i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (ii) një ankesë e verifikuar për zvarritje dhe njëanshmëri gjykimi, nga të cilat pretendimi për njëanshmëri është arkivuar si i pabazuar ndërsa ai për zvarritje i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik për tejkalim të afatit standard të gjykimit, pasi referuar kompleksitetit të çështjes, numrit të palëve ndërgjyqëse, shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë të justifikuar;
  - 1 ankesë e vitit 2013 verifikuar për zvarritje dhe shkelje formale ligji. Gjyqtares i është tërhequr vëmendja me shkrim për tejkalim të afatit standard të gjykimit për shkak të mosmenaxhimit të mirë të gjykimit;
  - 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për zvarritje. Gjyqtares i është tërhequr vëmendja me shkrim për tejkalim të afatit procedural për gjykimin e një kërkesë me objekt “kundërshtim veprimesh përmbartimore”;
  - 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për shkelje formale ligji, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Elona Toro, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për raportin e mbajtur nga KLGJ-ja**

Subjekti nuk ka pasur kundërshtime për të gjitha konstatimet e pasqyruara dhe aspektet e vlerësuara në raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish - KLD-së.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të

cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

### **Denoncimet e publikut të depozituara në Komision**

Komisioni, administroi dhe mori në shqyrtim 25 (njëzet e pesë) denoncime nga publiku. Denoncimet hidhnin dyshime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm etj.

#### 1) Denoncimi<sup>115</sup> i shtetasit M.A.

Denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, si gjyqtare e Shkallës së Parë Tiranë. Sipas denoncuesit, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Gjithashtu, denoncuesi sqaron se ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe se çështja është në listëpritje për t'u shqyrtuar nga kjo gjykatë.

Për sa më sipër, konstatohet se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

#### 2) Denoncimi<sup>116</sup> i shtetasit L.A.Ll.

Nga përmbajtja e kësaj ankese duket se denoncuesi pretendon se është zhvilluar proces gjyqësor pa dijeninë e të paditurve, pa u thirrur asnjëherë përgjatë periudhës 2012 – 2013. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga verifikimi i këtij vendimi nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro, të ketë qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar këtë çështje.

#### 3) Denoncimi<sup>117</sup> i shtetasit H.S.K.

Denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, si gjyqtare e Shkallës së Parë Tiranë (vendimi nr. \*\*\*, datë 20.2.2016).

Nga verifikimi i denoncimit konstatohet se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

Rezultoni se këtë ankesë denoncuesi e ka paraqitur edhe në KLD. Pas shqyrtimit të kësaj ankese, Inspektorati i KLD-së ka vendosur arkivimin e saj, pasi ka dalë në konkluzionin se ka të bëjë me pretendime për fakte apo rrethana që nuk përbëjnë objekt verifikimi nga ky Inspektorat, të cilat mund të zgjidhen nëpërmjet shqyrtimit gjyqësor mbi bazën e apelimit gjyqësor të palës.

#### 4) Denoncimi<sup>118</sup> i shtetasit A.N.

Ankesë për zvarritje procesi, në proces gjyqësor trashëgimie. Sipas denoncimit, znj. Elona Toro (Stavri) në cilësinë e relatores së trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë, në datën 19.12.2017, ka pranuar kërkesën e palës së paditur për njoftimin e palëve të treta, megjithëse nga pala e paditur ishte kërkuar vazhdimisht njoftimi i palëve të treta dhe se këto kërkesa ishin refuzuar nga trupi gjykues me arsyetimin se legjislacioni është i qartë për sa i përket gjykimeve në apel, pasi njoftimi në këtë gjykim bëhet vetëm me shpallje publike. Sipas denoncueses, gjyqtarja Elona Toro ka shpikur një normë të

<sup>115</sup>Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2017.

<sup>116</sup>Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017.

<sup>117</sup>Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017.

<sup>118</sup>Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2018.

re, që njoftimi në Apel i palëve të treta të bëhet me letërporosi, për më tepër deklaroi se këto palë kishin hequr dorë nga trashëgimia, me deklaram përpara gjykatës dhe noterit.

Pasi i kërkuar shpjegime lidhur me faktet e denoncuar në këtë ankesë, me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka sqaruar se nuk ka pasur aspak zvarritje të procesit dhe se në të kundërt është një proces që në Gjykatën e Apelit është zhvilluar në kohë rekord, regjistruar në korrik të vitit 2017, përfunduar më 6.2.2018. Pas kërkesës së palës paditëse, bashkëlidhur së cilës ka qenë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Apelit ka pranuar kërkesën për përsheptim të gjykimit duke e shpallur këtë çështje përpara radhës. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë kronologjike të gjithë procesin gjyqësor, i cili paraqitet me një natyrë komplekse, duke argumentuar se vonesat në këtë proces kanë ardhur kryesisht për shkak të shqyrtimit të kërkesave të kryera nga palët për “përrjashtim gjyqtari”.

Pas kërkesës së bërë nga pala e paditur në gjykim për njoftimin e personave të tretë në gjykim, të cilët ishin shtetas të huaj, Gjykata e Apelit Tiranë, ndonëse konstatoi se është ezuaruar procedura e njoftimit të personave të tretë nëpërmjet komunikimit me shpallje publike në stendën e Gjykatës së Apelit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë, me qëllim për të shmangur çdo paqartësi dhe në funksion të një procesi të rregullt ligjor me vendim të ndërmjetëm, vendosi të njoftojë edhe njëherë personat e tretë në mënyrën e parashikuar në Kodin e Procedurave Civile, pra, nëpërmjet shpalljes, por edhe nëpërmjet fletëthirrjes në adresën e përcaktuar nga i padituri (vëllai i personave të tretë) dhe njëkohësisht njoftim nëpërmjet autoritetit përgjegjës që është Ministria e Drejtësisë. Gjykata e Apelit (e cila kishte gjykuar më parë këtë çështje) në vendimin për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me trup gjykues tjetër, në detyrat e saj kryesore për të cilën ka prishur çështjen ka qenë thirrja në gjykim edhe e fëmijëve të tjerë të të ndjerit V. V., konkretisht tri vajzat e tij, të cilat ishin shtetase të huaja.

Lidhur me vendimin për njoftimin e personave të tretë edhe nëpërmjet fletëthirrjes në adresën e përcaktuar nga i padituri (vëllai i personave të tretë) dhe njëkohësisht njoftim nëpërmjet autoritetit përgjegjës që është Ministria e Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo nuk është bërë për të krijuar zvarritje në proces, por në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara, për të mos sjellë si pasojë cenimin e procesit gjyqësor, për të cilin vlerëson se është më i rëndësishëm se një proces i kryer shpejt e me gabime.

Për të provuar pretendimet e saj, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendime gjyqësore, vendime të ndërmjetme, procesverbale të seancave gjyqësore, si dhe kërkesa të ndryshme të palëve ndërgjyqëse që lidhen me zhvillimin e këtij procesi gjyqësor.

Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni nuk vërejtí problematika thelbësore për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe figurën e subjektit të rivlerësimit. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim duken bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

##### 5) Denoncim<sup>119</sup> i shtetasit M.B.

Denoncuesi ankohet për vendim të padrejtë, të marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe proces jo të rregullt ligjor.

---

<sup>119</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018.

Nga përmbajtja e ankimit rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.10.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.8.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke caktuar si masë sigurimi personal ndaj këtij shtetasi “arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Ankuesi pretendon se në marrjen e këtij vendimi, Gjykata e Apelit nuk ka verifikuar faktin nëse kishte kompetencë tokësore, pasi vepra penale për të cilën akuzohej kishte ndodhur në juridiksionin tokësor të rrethit Durrës.

Gjithashtu, ankuesi pretendon se gjykimi është bërë pa pjesëmarrjen e tij dhe as duke njoftuar avokatin e përzgjedhur, ndonëse njihej adresa (vijon të sqarohet ankuesi) e tij dhe e avokatit dhe për pasojë, prej ankuesit pretendohet se është zhvilluar një gjykim formal duke u mohuar në mënyrë arbitrare e drejta për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Pasi i kërkuam shpjegime lidhur me faktet e denoncuar në këtë ankesë, me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore subjekti ka sqaruar se:

i. në lidhje me çështjen e juridiksionit tokësor të pretenduar në denoncim, pretendimi i ankuesit nuk ka bazë ligjore provuese, pasi nga aktet e administruara në fashikullin e gjykimit rezulton se vepra penale është kryer në rrethin e Krujës (kallëzimi i bërë në stacionin e policisë Fushë-Krujë), e cila i përket juridiksionit të përgjithshëm të Gjykatës së Apelit Tiranë;

ii. trupi gjykues (në të cilin subjekti ka qenë në cilësinë e anëtares) për të mundësuar njoftimin e shtetasit nën hetim, krahas njoftimit me shpallje publike në stendat e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe në faqen zyrtare të kësaj gjykate, për shkak se çështja kishte të bënte me masë sigurimi është proceduar edhe me:

- a) njoftim me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2017, nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Rinas;
- b) njoftimin me telegram me konfirmim përgjigje në drejtim të shtetasit M.B., në adresën: hotel “\*\*\*”, Rinas;
- c) njoftim me telegram me konfirmim përgjigje në drejtim të avokatit M.R., Dhomës së Avokatisë Durrës, në datat 15.9.2017 dhe 20.9.2017;
- d) njoftim me telegram me konfirmim përgjigje në drejtim të përkthyesit A.H.

Mosgjetja në hotelin “\*\*\*”, Rinas (adresë në të cilën ka qenë i urdhëruar nga Gjykata e Shkallës së Parë qëndrimi i këtij shtetasi deri në përfundim të gjykimit) i të pandehurit nga Policia dhe shërbimi postar, mosparaqitja e avokatit të njoftuar, ka detyruar gjykatën të deklarojë mungesën dhe të procedojë gjykimin në mungesë, duke caktuar avokat kryesisht, konform nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, nuk u vërejtën problematika për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit, lidhur me këtë denoncim, janë bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

6) Denoncime<sup>120</sup> të shtetasve S., dhe H.R.

---

<sup>120</sup>Ankesat nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018; nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2018; dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2018.

Denoncuesi S.R., (i cili ka ndërruar jetë) i pasuar nga trashëgimtari i tij, shtetasi H.R., pretendojnë për zhvillim të një procesi gjyqësor jo të rregullt ligjor, zvarritje në proces, moszbardhje dhe vënie në dispozicion të vendimit për përjashtim gjyqtari, korrupsion, kontroll figure, si dhe aftësi profesionale.

Lidhur me pretendimin për vënien në dispozicion të vendimit për përjashtimin e gjyqtarit, Gjykata e Apelit Tiranë ka njoftuar ankuesin me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2018 (dokument i depozituar nga ankuesi) se gjendet në dosjen objekt gjykimi, e cila gjendet në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e këtyre denoncuesve për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

7) Denoncim<sup>121</sup> i shtetasit H.Sh.

Denoncuesi ankohet për vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, si gjyqtare e Shkallës së Parë Tiranë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Duket se kryesisht ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë.

Gjithashtu, denoncuesi referon se gjyqtarja Elona Toro, për këtë çështje të gjykuar prej saj, ka marrë vërejtje nga KLD-ja për zvarritje të procesit. Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosje konstatohet se denoncuesi, z. H.Sh., ka depozituar në KLD ankesë ndaj gjyqtares Elona Toro (Stavri) (ankesë nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2013), për çështjen e gjykuar prej saj, ku denoncuesi ka qenë palë dhe për të cilën gjyqtarja ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2009.

Konstatohet se nga analiza e të dhënave të verifikuara prej Inspektoratit të KLD-së, ka rezultuar se kjo çështje ka zgjatur 1 vit, 1 muaj e 28 ditë dhe referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të KLD-së, “sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, bashkëlidhur tij Aneksi 1, germa “e”, pika 5, përbën gjykim të kryer jashtë afatit kohor maksimal, të përcaktuar prej 6 muajsh. Gjithashtu, është konstatuar se gjykata është tërhequr për të shpallur vendimin 10 ditë pas dhënies së tij, veprim i cili bie ndesh me përcaktimet e nenit 308/2 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon afatin 5-ditor për shpalljen e vendimit të arsyetuar.

Megjithatë, Inspektorati i KLD-së ka arritur në përfundimin se faktet e këtij verifikimi nuk përmbushin kushtet e germës “a”, pikës 3 dhe nenit 32 të ligjit nr. 98877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, por bazuar në pikën 2, të nenit 34, të rregullores “për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, gjyqtares Elona Toro (Stavri) *i është tërhequr vëmendja me shkrim për shkelje formale të ligjit dhe zvarritje të gjykimit.*

Me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka sqaruar pozitën e saj lidhur me faktet e denoncuar. Komisioni vlerësoi me paanësi dhe objektivitet shpjegimet e dhëna dhe provat e depozituara nga subjekti lidhur me këtë denoncim.

Në vlerësim tërësor të këtij denoncimi, Komisioni vëren se në shqyrtimin e kësaj ankese subjektit i është tërhequr vëmendja me shkrim nga inspektorati përkatës, por faktet e denoncuar nuk përbëjnë shkak për nisjen e procedimit disiplinor. Si rrjedhojë, Komisioni çmon se ky rast përbën rast të veçuar dhe jo rregull në standardin e gjykimit të subjektit të rivlerësimit dhe, si i tillë, meqenëse nuk

---

<sup>121</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2018.



rezultojnë problematika thelbësore, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale, nuk do të merret në konsideratë gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar.

8) Denoncim<sup>122</sup> i shtetasit A.Sh.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri), për vendimmarrje të padrejtë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Denoncuesi hedh dyshime për kryerjen e veprimeve korruptive nga trupi gjyqësor ku bën pjesë dhe subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se ky trup gjykues ka kryer shkelje të rëndë ligjore, pasi ka dhënë vendim pa pritur që prokuroria të shprehej me vendim përfundimtar, për të cilin lidhur me objektin e gjykimit civil kishte bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vijim, denoncohet se kjo gjyqtare ka gjykuar edhe më parë çështje që kanë të bëjnë me pjesë pasurie, të cilat janë objekt i këtij gjykimi. Denoncuesi referon se të dy vendimet janë prishur nga Gjykata e Apelit. Ndër të tjera, bashkëlidhur ka dërguar vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (dhënë nga gjyqtare Elona Toro) dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (marrë nga trupi gjykues në përbërje të të cilit në cilësinë e anëtares është gjyqtarja Elona Toro).

Çështja nr. 1

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtare Elona Toro (Stavri), me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.2005, për çështjen me palë paditëse, z. H.Sh., (babai i denoncuesit), palë të paditur, z. H.B., me objekt “detyrimi i të paditurit të lirojë e dorëzojë banesën paditësit”, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.4.2007, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me trup gjykues tjetër, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e hetim të gjithanshëm. Gjykata e Apelit ka vërejtur se vendimi nr. \*\*\*, datë 30.12.2005 i Gjykata së Shkallës së Parë Tiranë është në zbatim të gabuar të ligjit procedural, duke konstatuar shkelje të rënda procedurale, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës kryesisht, pasi nuk është formuar drejt ndërgjyqësia.

Çështja nr. 2

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues në përbërje të të cilit është edhe gjyqtarja Elona Toro (Stavri), me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, për çështjen me palë paditëse, z. H.Sh., etj., palë të paditur AKKPIshP, Zyra Rajonale Tiranë e AKKP-së, z. A.F., etj., me objekt “anulimi i pjesshëm i vendimit nr. \*\*\* datë 29.9.1994 dhe vendimit nr. \*\*\*, datë 15.3.1996 të KKKP IshP”, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjen për rigjykim në po këtë gjykatë, por me trup gjykues tjetër, për shkak të zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor, lidhur me formimin e trupit gjykues.

Konstatohet se gjatë zhvillimit të këtij gjykimi, pala paditëse ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares Elona Toro (Stavri), me arsyetimin se ka dhënë një vendim tjetër, lidhur me pronën objekt gjykimi (çështja nr. 1). Me vendim të ndërmjetëm Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur të mos pranojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtares, me arsyetimin se gjykimi i zhvilluar prej saj nuk ka lidhje me çështjen objekt të këtij gjykimi. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja Elona Toro (Stavri) ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, duke i parashtruar kryetarit të gjykatës se në kushtet kur vendimi

<sup>122</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2018.

i ndërmjetëm i gjykatës ishte marrë me shumicë votash, për të njëjtin shkak që kishte paraqitur pala paditëse, jepte dorëheqjen nga gjykimi. Kjo kërkesë është refuzuar nga kryetari i gjykatës.

Lidhur me pretendimin se është dhënë vendim pa pritur që prokuroria të shprehej me vendim përfundimtar për aktin që pretendohet nga paditësit si i falsifikuar dhe për të cilin ishte regjistruar procedim penal duket se:

Nga aktet e dërguara nga denoncuesi konstatohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2009 i ka kthyer për plotësim kallëzimin e depozituar nga shtetasi A.Sh., dhe se referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit kallëzues të shtetasit A.Sh., ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 17.1.2010 për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur me vendim në datën 8.12.2009.

Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me faktet e denoncuara në këtë ankesë (dy çështjet gjyqësore të gjykuara prej saj), me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore lidhur me çështjen nr. 1 të këtij denoncuesi, vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim për të cilin Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural, sepse nuk është formuar drejt ndërgjyqësia, subjekti ka sqaruar se:

Së pari, shtetasi A.Sh., nuk ka qenë palë ose përfaqësues në gjykim dhe, si i tillë, i mungon legjitimiteti aktiv në këtë procedurë hetimi administrativ. Por, gjithsesi subjekti ka dhënë parashtimet e saj lidhur me këtë denoncim.

Së dyti, në këtë gjykim ( i referohet çështjes për të cilin është dhënë vendimi nr. \*\*\*, datë 17.4.2007) pala paditëse kishte thirrur në gjykim me cilësinë e të paditurit vetëm shtetasin H.B. Nisur nga ky fakt, subjekti sqaron se në mënyrë konsekuente gjatë gjykimeve të saj ka konsideruar se vetëm paditësi zotëron të drejtën e padisë dhe krijimin e ndërgjyqësisë, në referim të neneve 2, 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim shpjegon se parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, sipas të cilit iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveçse kur ligji e parashikon ndryshe (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala paditëse që përcakton objektin e gjykimit mbi të cilin do të shprehet gjykata (shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Në këto kushte, subjekti pretendon se Gjykata e Faktit, gjatë gjykimit, është në pamundësi objektive të shtojë ndërgjyqësinë me të paditur të tjerë pa u investuar nga paditësi në formën e kërkuar nga ligji procedural.

Komisioni vlerëson se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë çështje. Për më tepër, denoncimi ka të bëjë me çështje të gjykuar në vitin 2005 nga subjekti i rivlerësimit, kohë e cila referuar pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, për efekt të këtij procesi.

Lidhur me çështjen e dytë të denoncuar, subjekti ka sqaruar se si gjyqtare ka dhënë dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje duke i parashtruar kryetarit të gjykatës shkaqet që do të evitonin dyshimin për njëanshmëri nga palët, por kjo kërkesë u refuzua prej tij.

Në vijim subjekti ka argumentuar se megjithëse Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me trup gjykues tjetër, në rigjykimin e kësaj çështjeje me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.3.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “pushimin e gjykimit të çështjes” për shkak të

mosparaqitjes së palëve paditëse, denoncuesit A.Sh., etj., në gjykim, konform nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile. Thënë ndryshe ka pasur mungesë të interesit nga paditësi.

Nga vlerësimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me trajtimin e kësaj ankese për sa i përket fakteve të denoncuara për çështjen nr. 2, nuk konstatohen problematika thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Denoncimi lidhur me këtë çështje, duket se ka të bëjë kryesisht me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

#### 9) Denoncimi<sup>123</sup> i shtetasit S.Ç.

Nga verifikimi i këtij denoncimi duket se bëhet fjalë për një vendim të marrë në vitin 1996, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e trupit gjykues. Denoncuesi nuk referon të dhëna konkrete për shkelje të natyrës procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Për më tepër, denoncimi ka të bëjë me çështje të gjykuar në vitin 1996 nga subjekti i rivlerësimit, kohë e cila referuar pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, për efekt të këtij procesi.

#### 10) Denoncimi<sup>124</sup> i shtetasës M.N.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri) për njëanshmëri në procesin gjyqësor civil, ku denoncuesja paraqitet si palë. Sipas denoncueses, procesi gjyqësor i zhvilluar ka qenë i parregullt, pasi gjyqtarja ka administruar prova dhe dokumente false në dosjen gjyqësore. Gjithashtu, denoncuesja hedh dyshime se ky vendim mund të jetë marrë i ndikuar nga dhënia e ryshfetit prej palës kundërshtare.

Denoncuesja, nisur nga fakti se ka pasur dyshime për njëanshmëri, ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtares Elona Stavri (Toro), kjo edhe për shkak se pas kërkesës së bërë për vënien në dispozicion të regjistrimit audio të një seance, zhvilluar datë 8.11.2013, gjykata ka informuar se nga verifikimet e kryera nuk rezulton që kjo seancë të jetë zhvilluar me sistemin e regjistrimit audio.

Konstatohet se Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, për të cilin denoncohet gjyqtarja Elona Toro.

Nga verifikimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e kësaj denoncueseje për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në figurën e subjektit të rivlerësimit.

#### 11) Denoncim<sup>125</sup> i shtetasës T.D.D.

Denoncuesja pretendon se gjyqtarja Elona Toro (Stavri), në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka zhvilluar proces jo të rregullt ligjor, pasi ka gjykuar si gjyqtare e vetme në një gjykim, që sipas saj duhej të zhvillohej me 3 gjyqtarë sepse bëhej fjalë për shuma të mëdha. Denoncuesja i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.2.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>123</sup> Ankesë nr. \*\*\*prot., datë 21.6.2018.

<sup>124</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2018.

<sup>125</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2018.

Nga verifikimi i denoncimit vërehet se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, nga verifikimi i vendimit të dërguar bashkëlidhur denoncimit vërehet se denoncuesja, znj. T.D.D., nuk është palë ndërgjyqëse në këtë proces.

Referuar germës “a”, të nenit 35, të Kodit të Procedurës Civile: *“Gjykata e Shkallës së Parë gjykon me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar ose tre gjyqtarë paditë me vlerë më shumë se 20.000.000 lekë, vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi”*.

Por, nga verifikimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.2.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konstatohet se objekti i padisë ka qenë: *“Pavlefshmëria e dëshmisë së trashëgimisë së z. P. D., sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 10.4.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe sigurimin e padisë mbi të gjitha pasuritë që janë fituar sipas kësaj dëshmie trashëgimie”*. Pra, konstatohet se vendimi gjyqësor në objektin e tij nuk pasqyron vlera monetare.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri).

12) Denoncim<sup>126</sup> i shtetasit M.H., me cilësinë e avokatit

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit penal të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 3.7.2018, ku si anëtar i trupit gjykues ka qenë subjekti i rivlerësimit, vendim i cili rezulton të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë (rekursi është depozituar nga ankuesi, bashkëngjitur ankimit të tij).

Nga analizimi i këtij denoncimi konstatohet se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe, për pasojë, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

13) Denoncim<sup>127</sup> i shtetasit B.Ç.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 5.7.2018, ku si anëtar i trupit gjykues ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri).

Nga analizimi i këtij denoncimi konstatohet se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

14) Denoncim<sup>128</sup> i \*\*\*, shoqëria kursim-kredi “\*\*\*\*”

Denoncuesi ankohet për shkelje ligjore në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 19.7.2018, me objekt “kthim shume”.

Nga analizimi i këtij denoncimi duket se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

Gjithashtu, konstatohet se denoncuesi e ka paraqitur këtë ankesë edhe në KLD, ku pas shqyrtimit të saj Inspektorati i KLD-së ka vendosur arkivimin e saj.

15) Denoncim<sup>129</sup> i shtetasit B.M.

---

<sup>126</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2018.

<sup>127</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2018.

<sup>128</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2018.

<sup>129</sup> Ankesat nr. \*\*\* prot., datë 9.8.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 7.6.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i dhënë nga gjyqtarja Elona Toro (Stavri). Denoncuesi pretendon se gjyqtarja Elona Toro ka dhënë vendim haptazi të padrejtë, bazuar në dokumente të falsifikuara, të dorëzuara nga i padituri/kundërpaditës, për të cilat pas kallëzimit të bërë nga denoncuesi i padituri/kundërpaditës është dënuar penalisht.

Sipas denoncuesit, vendimi i marrë nga gjyqtarja Elona Toro u quajt i padrejtë nga Gjykata e Apelit dhe u kthye për rishqyrtim me trup gjykues tjetër, por denoncuesi nuk ka bashkëlidhur kopje të këtij vendimi.

Lidhur me këtë denoncim, nga verifikimi i akteve të depozituara nga subjekti dhe shpjegimeve të dhëna prej saj konstatohet se me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.6.2004 me palë ndërgjyqëse paditës/i kundërpaditur B.M., i paditur/kundërpaditës S.S., me objekt padie “pushim cenimi të pronësisë mbi një sipërfaqe truall” dhe objekt kundërpadie: “detyrimin e paditësit të kundërpaditur ta njohë pronar mbi sipërfaqen 220 m<sup>2</sup> dhe i shtëpisë mbi të”, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë (gjyqtarja Elona Toro) ka vendosur “Pranimin e kundërpadisë. Detyrimin e paditësit të kundërpaditur B.M., të njohë pronar të paditurin/kundërpaditës S.S., për sipërfaqen e truallit 220 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen ‘\*\*\*\*’, Rr. ‘\*\*\*\*’, truall objekt konflikti”.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.4.2005, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.6.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate me trup gjykues tjetër”.

Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se me pranimin e kundërpadisë gjykata e faktit nuk ka formuar drejt ndërgjyqësinë, pasi duhet të thërriste edhe bashkëpronarët e tjerë të kësaj pasurie.

Lidhur me këtë fakt, subjekti sërish sqaron se në mënyrë konsekuente gjatë gjykimeve të saj ka konsideruar se vetëm paditësi zotëron të drejtën e padisë dhe krijimin e ndërgjyqësisë, në referim të neneve 2, 3 dhe 5 të Kodit të Procedurës Civile.

Në vijim, subjekti shpjegon se parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil, sipas të cilit iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor dhe kundërpaditësit kur kundërpadia ka lidhje me kërkesëpadinë ose midis tyre bëhet kompensim (neni 160 i Kodit të Procedurës Civile), përveçse kur ligji e parashikon ndryshe (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala paditëse që përcakton objektin e gjykimit mbi të cilin do të shprehet gjykata (shihni vendimin nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese).

Në këto kushte, subjekti pretendon se Gjykata e Faktit, gjatë gjykimit, është në pamundësi objektive të shtojë ndërgjyqësinë me të paditur të tjerë pa u investuar nga paditësi (apo kundërpaditësi) në formën e kërkuar nga ligji procedural.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin tjetër të paraqitur nga denoncuesi se Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur mbi dokumente të falsifikuara, subjekti i rivlerësimit argumenton se një pretendim i tillë nuk është ngritur asnjëherë në gjykim, ku pala të pretendonte fillimin e çështjes penale. Veç kësaj edhe në ankimin e ushtruar nga paditësi/denoncues, ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nuk rezulton të jetë përmendur një fakt i tillë si shkak ankimi, sikurse edhe Gjykata e Apelit në vendimin e saj i referohet vetëm ndërgjyqësisë si shkak për prishjen e vendimit.

Vërehet se pavarësisht këtij pretendimi, nga leximi i vendimit nr. \*\*\*, datë 7.6.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë rezulton qartë se pranimi i kundërpadisë mbështetet tek efektet e parashkrimit fitues,

i cili ka si kriter posedimin efektiv dhe të qetë të sendit në kohëzgjatjen e përcaktuar nga ligji dhe jo në dokumentet e pretenduar nga denoncuesi.

Po kështu, nga verifikimi i akteve të depozituara nga denoncuesi, konstatohet se vendimi penal nr. \*\*\*, datë 18.12.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është një vendim i cili rezulton të jetë marrë rreth dy vjet e gjysmë më vonë se vendimi nr. \*\*\*, datë 7.6.2004, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (i gjyqtarës Elona Toro), për të cilin ankohet denoncuesi.

Për më tepër, Komisioni vëren se denoncimi ka të bëjë me çështje të gjykuar në vitin 2004 nga subjekti i rivlerësimit, kohë e cila referuar pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016 nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, për efekt të këtij procesi.

Për sa më sipër, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, nuk u vërejtën problematika për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe figurën e subjektit të rivlerësimit.

16) Denoncim<sup>130</sup> i shtetasit Xh.M.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 23.11.2017, ku si anëtar i trupit gjykues ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri), vendim i cili rezulton të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë (rekursi është depozituar nga ankuesi, bashkëngjitur ankimit të tij).

Nga analizimi i këtij denoncimi konstatohet se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe, për pasojë, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

17) Denoncim<sup>131</sup> i shtetasit K.J.

Denoncuesi ankohet për shkelje ligjore në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. \*\*\*, datë 6.12.2013. Denoncohet subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri), për zvarritje të procesit gjyqësor, duke simuluar për 26 muaj mosekzekutimin e titullit të ekzekutimit të qershorit 2005, se ka kryer 18 seanca të panevojshme, nga të cilat 7-8 seanca të shtyra për mosformimin e trupit gjykues.

Sipas denoncuesit, megjithëse gjykata e pushoi gjykimin, gjyqtarja la në fuqi masën e pezullimit. Denoncuesi pretendon se prej vonesave të krijuara në proceset e tjera gjyqësore, vendimeve të ndërmjetme të gjykatave, si edhe vendimmarrjes së gjyqtarës Elona Toro, e cila la në fuqi masën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe lirimin e sendit për disa vjet, kjo masë u shua juridikisht, megjithëse pala kundërshtare i humbi të gjitha gjyqet. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit, fotokopje të faqes së parë të vendimit të sipërcituar, si dhe fotokopje të faqes së parë të dosjes gjyqësore.

Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me faktet e denoncuara në këtë ankesë, me prapësimet e sjella mbas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, lidhur me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (vendimi objekt ankese), subjekti ka sqaruar se shtetasi K.J., nuk ka qenë palë ose përfaqësues në gjykim dhe, si i tillë, i mungon legjitimiteti aktiv në këtë procedurë hetimi administrativ. Por, gjithsesi subjekti ka dhënë parashtrimet e saj lidhur me këtë denoncim.

Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti, ku paraqitet në mënyrë të detajuar kronologjia e këtij procesi gjyqësor, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit provues të depozituar me dërgimin e

<sup>130</sup> Ankesat nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2018.

<sup>131</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2018.

prapësimeve pas rezultateve të hetimit (vendime gjyqësore, kërkesa të palëve që lidhen me këtë çështje), vërehet se gjatë gjithë procesit gjyqësor nuk rezulton që subjekti (qoftë edhe si pjesë e trupit gjykues) të ketë dhënë ndonjë masë pezullimi, e cila do të duhet të kishte penguar ndonjë fazë ekzekutimi sikurse ka pretenduar denoncuesi, i cili nuk ka qenë palë në proces.

Lidhur me pretendimin për zvarritje të këtij procesi, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar prej tij, si dhe kompleksitetit të çështjes, duket se ky gjykim nuk është kryer brenda një afati të arsyeshëm (sipas shpjegimeve të subjektit dosja e hedhur në short dhe e regjistruar në emrin e gjyqtarës Elona Toro, në dhjetor të vitit 2012 dhe vendimi është shpallur në datën 6.12.2013). Por nga ana tjetër, nga verifikimi i fakteve të parashtruara në vendim vërehet se disa seanca janë shtyrë për mosparaqitjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre, pa shkaqe të arsyeshme.

Gjithsesi, Komisioni vlerëson se nga vlerësimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara nga subjekti lidhur me trajtimin e kësaj ankese, nuk konstatohen problematika thelbësore, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe në këtë kuptim ky denoncim nuk do të merret në konsideratë gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar.

#### 18) Denoncim<sup>132</sup> i shtetasit R.D.

Denoncohet subjekti i rivlerësimit për shkelje të natyrës procedurale, pasi nuk është njoftuar për gjykimin që ka zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, në asnjë nga format e njoftimit (fletëthirrje apo telefon). Gjithashtu, ankuesi denoncon gjyqtaren për marrjen e vendimit të gabuar.

Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka parashtruar se referuar nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se: *“...njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga Gjykata e Apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes...”*, lidhur me këtë çështje njoftimi i palëve në gjykim është bërë nëpërmjet listëshpalljes së datës 17.9.2018, ku palët R.D., paditës dhe E.T., e paditur janë ftuar për gjykim në datën 11.10.2018, ora 11:00, salla 2.

Subjekti ka depozituar si provë shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2020 të kryesekretarisë së Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilës konfirmohet fakti i afishimit të listës së gjykimeve për muajin tetor 2018, listë e cila ndodhet e ruajtur në arshivën e kësaj gjykate, por edhe e ruajtur dhe e publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndërsa pretendimet që lidhen me mënyrën e përfundimit të themelit të çështjes gjyqësore nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

#### 19) Denoncim<sup>133</sup> i shtetasit A.B.

Denoncohet, ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e korruptuar dhe se ka dhënë vendime bazuar në dokumente të falsifikuara.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk vërehen fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri).

<sup>132</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2018.

<sup>133</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 39.1.2019.

20) Denoncim<sup>134</sup> i shtetases E.C.

Nga përmbajtja e denoncimit vërehet se kemi të bëjmë me pretendime, të cilat nuk lidhen me çështje konkrete të gjykuara nga gjyqtarja Elona Toro (Stavri). Denoncuesi referon një proces gjyqësor penal, por nuk ka pasqyruar të dhëna konkrete lidhur me vendim/vendime të marra nga gjyqtarja Elona Toro dhe gjithashtu nuk i ka bashkëlidhur denoncimit asnjë material shtesë, që të ketë të bëjë me procese gjyqësore të zhvilluara nga ky subjekt rivlerësimi.

Për sa më sipër, lidhur me trajtimin e këtij denoncimi, Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumentacion mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri).

21) Denoncim<sup>135</sup> i shtetasit M.P.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 16.10.2018, ku si anëtar i trupit gjykues ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri).

Në analizë të vendimit duket se Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka administruar ankimin dhe provat, ka vlerësuar se në kuptim të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm referuar neneve 466/ç dhe 467/e të Kodit të Procedurës Civile të prishë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke e kthyer çështjen për rigjykim.

Duket se ky denoncim ka të bëjë me aspekte të vendimmarrjes, të cilat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

22) Denoncim<sup>136</sup> i shtetasve A., dhe D.P.

Denoncuesi ankohet për vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 11.6.2019, ku pjesë e trupit gjykues (si anëtare) që ka dhënë vendimin ka qenë gjyqtarja Elona Stavri (Toro). Denoncuesi pretendon se Gjykata e Apelit ka kryer shkelje të shumta të natyrës procedurale në marrjen e këtij vendimi, të cilat i ka listuar në ankesën e tij.

Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me faktet e denoncuara në këtë ankesë, me prapësimet e sjella mbas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka argumentuar se përmbajtja e kësaj ankese është e lidhur tërësisht me themelin e çështjes. Pretendimi se gjykata ka vepruar në tejkalim të kërimit të paditësit, është i pabazuar në dosjen gjyqësore. Fakti që në gjykimin e shkallës së parë padia është pranuar pjesërisht dhe të dy palët kanë investuar Gjykatën e Apelit me ankimet e tyre përkatëse nuk do të thotë që Gjykata e Apelit nuk mund të ketë një qëndrim të ndryshëm (pjesërisht apo plotësisht) mbi faktet dhe ligjin e zbatuar. Palët kanë marrë pjesë rregullisht në gjykim, pasi janë njoftuar me shpallje publike.

Komisioni vlerëson se duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me këtë denoncim. Nga verifikimi dhe analizimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e këtyre denoncuesve për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Nga verifikimi i këtij denoncimi konstatohet se nuk ka *indicie* për të provuar pretendimet e këtyre denoncuesve për gjetje, që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në figurën e subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>134</sup>Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019.

<sup>135</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2019.

<sup>136</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2019.



23) Denoncim<sup>137</sup> i shtetasës E.J.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 14.5.2019, ku si kryesues (relator) i trupit gjykues ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri), vendim i cili rezulton të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë.

Duket se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe, për pasojë, trajtimi i saj nuk është në kompetencë të Komisionit.

24) Denoncim<sup>138</sup> i shtetasit V.Ç.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Toro (Stavri). Denoncuesi nuk specifikon asnjë ankesë lidhur me subjektin e rivlerësimit.

25) Denoncim<sup>139</sup> i shtetasit D.H.

Nga analizimi i këtij denoncimi duket se ankimi i përket shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është Gjykata e Shkallës më të Lartë. Në kushte të tilla, trajtimi i tij nuk është në kompetencë të Komisionit.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është *eficient* dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në

<sup>137</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2019.

<sup>138</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2019.

<sup>139</sup> Ankesë nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2020.

nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.06.2020.

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**

Kryesuese

**Pamela QIRKO**

Relatore

**Etleđa ÇIFTJA**

Anëtare në pakicë/kundër

*Gledis Hajdini*  
*Sekretare gjyqësore*